



“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Hartimi i këtij studimi është pjesë e projektit “Unë zgjedh Europën”, i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe i zbatuar nga Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT dhe Qendra “Streha” në Shqipëri. Ky botim reflekton pikëpamjet e Qendrës Streha dhe të studjuesve që kanë hartuar studimin dhe nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Qendra Streha falenderon studjueset që hartuan studimin Dr. Elda Zotaj dhe M.sc. Gentiola Madhi dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në realizimin e studimit.

Pasqyra e lëndës

<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	5
<i>Executive Summary</i>	9
Lista e shkurtesave.....	13
Lista e tabelave	14
Lista e figurave.....	15
Hyrje 17	
Metodologjia e studimit	19
<i>Karakteristikat e të anketuarve</i>	21
1. Zhvillimet e Shqipërisë drejt proceseve integruese europiane	22
2. Liritë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri	24
2.1. Aktet ndërkombëtare kryesore në fushën e të drejtave të njeriut	26
2.2. Korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut	30
2.3. Progresi në zbatimin e disa të drejtave substanciale në kontekstin shqiptar	34
<i>2.3.1 E drejta e pronës</i>	34
<i>2.3.2 E drejta për arsim</i>	35
<i>2.3.3 E drejta për kujdes shëndetësor</i>	37
<i>2.3.4 Të drejtat e fëmijeve</i>	38
2.4. Progresi në zbatimin e të drejtave themelore të katër grupeve vulnerabël	40
<i>2.4.1 Barazia gjinore</i>	40
<i>2.4.2 Të drejtat e personave LGBTI</i>	43
<i>2.4.3 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara</i>	45
<i>2.4.4 Komunitetet Rome dhe Egjiptiane</i>	48
3. Analiza e gjetjeve	49
3.1. Analiza e Seksionit A: “Demografia”	49
3.2. Analiza e seksionit B: “Njohuri mbi Bashkimin European”	53

3.3. Analiza e seksionit C: “Njohuri mbi integrimin e Shqipërisë drejt BE-së”	55
3.4. Analiza e intervistave me përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë 71	
Konkluzione dhe rekomandime	79
1. Referenca	85
Shtojca 1: Tabela plotësuese	87
Shtojca 4: Lista e të intervistuarve.....	90

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë dy dekadave të fundit në Shqipëri janë realizuar një mori studimesh që kryesisht kanë patur në fokus analiza dhe gjetje që lidhen me perceptimin e qytetarëve për Bashkimin Europian dhe proceset integruese, por studime të fokusuara mbi perceptimin e grupeve të marginalizuara mbi BE-në dhe procesin e integritit mungojnë. Studimi “Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut” i realizuar si pjesë e projektit “Unë zgjedh Europën” është një hulumtim mbi ballafaqimin e këndvështrimeve të grupeve të marginalizuara me pjesën tjetër të shoqërisë për integrimin e vendit në BE-në. Ai synon të ofrojë një panoramë të perceptimeve të të rinjve në përgjithësi dhe të grupeve të marginalizuara në veçanti mbi procesin e integritit europian të Shqipërisë, si dhe se si ata e shohin nivelin e zbatimit të kornizës ligjore në fuqi mbi respektimin e të drejtave të njeriut.

Studimi paraqet gjetje nga analizimi i tre burimeve primare krahas shqyrtimit të bazës ligjore dhe dokumenteve relevante përmes trajtimit të një qasje krahasuese dhe nga ky këndvështrim ofron një vlerë të shtuar dhe një studim bazë për të vijuar më pas me analiza të mëtejshme. Studimi eksploron më shumë ballafaqimin e perceptimeve, nivelin e njohurive të të anketuarve, përmes dy kampionëve atyre online dhe offline, si dhe shqyrtimin e këndvështrimit të ekspertëve përmes intervistave të realizuara.

Më poshtë jepet një përmbledhje e gjetjeve kryesore:

➤ **80%** e kampionit offline (të anketuar në terren) deklarojnë se janë *pa njohuri ose me njohuri minimale* dhe vetëm 20% e tyre grupohen si njohës mesatar, të mirë apo shumë të mirë të institucioneve të Bashkimit Europian.

60% e kampionit online (të anketuar përmes internetit) deklarojnë se janë pak a shumë në *nivelin mesatar dhe njohuri të mira* rreth institucioneve të Bashkimit Europian.

- Vetëm **23.9%** e kampionit offline i cilësojnë *shumë të rëndësishme* politikat që lidhen me ‘Demokracinë, respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe pakicave në shtetet anëtare’.
Mbi **45%** e kampioni online i *vlereson të gjitha politikat*, madje ‘Demokracinë dhe respektimin e të drejtave themelore’ i vlerëson si *shumë të rëndësishme* në masën 57.4%.
- Rreth **50%** e kampionit offline shpreh një mungesë të theksuar interesi për të marrë informacion mbi aspekte të caktuara të historisë, politikave të BE-së apo proceseve integruese etj.
92% e kampionit online janë të interesuar të marrin informacion për aspekte si “Procesi i negociatave dhe anëtarësimi në BE” apo “BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor”.
- Pro-integrimit të Shqipërisë drejtë Bashkimit Europian janë rreth **88-90%** e pjesëmarrësve në të dy kampionët e studimit.
- Rreth **39.2%** e kampionit offline nuk e dinë që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian dhe shtetet anëtare të tij, e *detyron* Shqipërinë të respektojë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Europë të Re; ndërsa **80.3%** e kampioni online kanë pranuar se e dinë një gjë të tillë.
- **68.8%** e kampionit offline deklarojnë që *JO* ose *Nuk e dinë* që Shqipëria ka ratifikuar pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore, dhe vetëm **40%** e tyre dinë se reforma në drejtësi mbështetet fuqishëm nga Bashkimi Europian.
64% e kampionit online deklarojnë se *e dinë* që Shqipëria ka ratifikuar pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore, dhe vetëm **82%** e tyre dinë se reforma në drejtësi mbështetet fuqishmisht nga Bashkimi Europian.
- **49.2%** e kampionit offline pranojnë se e ‘drejta e pronës’ *nuk zbatohet fare*, dhe vetëm 1.7% e tyre besojnë se zbatohet shumë.

**“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor
për të drejtat e njeriut”**

40.2% e kampionit online pohojnë gjithashtu se e ‘drejta e pronës’ *nuk zbatohet aspak* dhe rreth 1.6% që zbatohen shumë. Perceptimet tek të dy kampionet në lidhje me këtë të drejtë janë shumë të përafërta.

- Mbi **60%** e kampionit offline perceptojnë se e drejta për arsim *nuk zbatohet ose zbatohet pak*, ndërsa kampioni online në masën **9.3%** shprehet se nuk ‘zbatohet aspak’, dhe **38.7%** mendojnë ‘mjaftueshëm’.
- Mbi **40%** e të dy kampionëve kishin perceptimin që ‘dinjiteti njerëzor dhe barazia’ në Shqipëri *zbatohet pak*, dhe vetëm një përqindje e vogël rreth **2%** pohojnë se zbatohet shumë.
- **49.5%** e kampionit offline perceptojnë se nuk ka ‘*aspak arritje*’ përsa i takon respektimit të të drejtave themelore dhe **54.1%** perceptojnë gjithashtu se nuk ka “aspak arritje” përsa i takon ‘*forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës*’. Mbi **80%** e kampionit offline rezulton në kufirin e një perceptimi tejet pesimist ndërmjet *aspak* dhe *pak arritje* në përmbushjen e kriterëve të antarësimit të bëra nga vendi i tyre.
- Rreth **16.4%** e kampionit online mendojnë që nuk ka ‘*aspak arritje*’ për fusha si përafrimi i legjislacionit me BE-në dhe **35.2%** e tyre besojnë që nuk ka ‘*aspak arritje*’ për kriteret si ‘*stabilitet institucional dhe stabilitet politik*’.
- **63.8%** e kampionit offline dhe **72.1%** e kampionit online ndajnë të njëjtin opinion duke i parë zhvillimet e bëra gjatë pesë viteve të fundit në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga shteti shqiptar si ‘*arritje të pakta*’.
- **63.2%** e kampionit offline nuk është në dijeni që ka një Ligj për ‘Mbrojtjen nga Diskriminimi’ dhe **66.5%** nuk e dinë gjithashtu që ka një Ligj për Informim. Përafërsisht **10%** e kampioni online nuk kanë njohuri për instrumentet ligjorë të sipërpërmëndur.
- **47.2%** e kampionit offline dhe **49.15%** e kampionit online shohin varësi mes avancimit të vendit në BE dhe përmirësimit të situatës ekonomike personale.

- **60.5%** e kampionit offline dhe **55.8%** e kampionit online shohin varësi mes avancimit të vendit në BE dhe zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes të të drejtave personale.
- **65.8%** e kampionit offline pranojnë se në një formë apo në një tjetër kanë marrë trajtim të diferencuar nga institucionet publike dhe vetëm **34.2%** e tyre pohojnë se nuk janë trajtuar ndryshe. **64.8%** e kampionit online pohojnë se nuk janë trajtuar ndryshe dhe rreth **35.2%** pranojnë se për një nga arsyet e renditura kanë ndjerë trajtim të diferencuar.
- Vetëm **8.3%** e kampionit offline dhe **6.5%** e kampionit online kanë pranuar se kanë bërë ankesë për trajtimin e diferencuar nga institucionet publike.
- **81.1%** e kampionit offline pranojnë se kanë menduar të largohen nga vendi. **77.5%** e të intervistuarve që i përkasin komunitetit LGBTI deklarojnë se duan të ikin. **83.3%** e komunitetit rom dhe egjiptian deklarojnë gjithashtu se duan të largohen.
- **74.1%** e të anketuarve në terren deklarojnë se duan të largohen si *azilkërkues*.
- **91.3%** e të anketuarve në terren pranojnë se arsyeja e largimit është ekonomike, sikundër **80%** pranojnë se arsyeja është mungesa e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut apo **57%** e tyre identifikojnë si shkak dhe dhunën.

Executive Summary

Over the past two decades, a number of studies have been conducted in Albania, focusing mainly on the findings related to citizens' perceptions of the European Union and integration processes, but studies focused on the perception of marginalized groups on the EU accession are missing. The study "Perceptions on EU Integration and Implementation of the Legal Framework for Human Rights" conducted as part of the "I Choose Europe" project is a research on the perspectives of marginalized groups with the rest of society on integrating the country into the EU. EU. It aims to provide an overview of the perceptions of young people in general and of marginalized groups in particular on Albania's European integration process, as well as how they see the level of implementation of the applicable legal framework on respect for human rights.

The study presents findings from analyzing the three primary sources in addition to examining the legal basis and relevant documents through a comparative approach, and from this perspective offers an added value and a baseline study to follow up with further analysis. The study explores more the conflicting perceptions, the level of knowledge of the respondents, through both online and offline sampling, as well as examining the experts' point of view through interviews.

The following is a summary of the main findings:

- 80% of the offline sample (surveyed in the field) declare that they are unknowing or with minimal knowledge and only 20% of them are grouped as average, good or very good connoisseurs of EU institutions.
- 60% of the online sample (surveyed via internet) state that they are more or less at average level and have good knowledge about EU institutions.
- Only 23.9% of the offline sample consider policies related to 'Democracy, respect for fundamental human and minority rights in member states' very important.

- Over 45% of online champions value all policies, even 'Democracy and respect for fundamental rights' rate it as very important at 57.4%.
- About 50% of the offline sample expresses a marked lack of interest in obtaining information on certain aspects of history, EU policies or integration processes, etc.
- 92% of the online sample are interested in obtaining information on aspects such as the "Negotiation process and EU membership" or "EU and Western Balkan countries".
- Albania's pro-integration into the European Union is about 88-90% of participants in both study samples.
- About 39.2% of the offline sample do not know that the Stabilization and Association Agreement with the European Union and its member states obliges Albania to respect the general principles of democracy and human rights, as stated in the Universal Declaration of Rights. Human Rights and as defined in the European Convention on Human Rights, the Helsinki Final Act and the Paris Charter for a New Europe; while 80.3% of the online sample admitted they knew so.
- 68.8% of the offline sample stated that NO or Don't know that Albania has ratified almost all international conventions for the protection of fundamental rights, and only 40% of them know that justice reform is strongly supported by the European Union.
- 64% of online sample say they know that Albania has ratified almost all international conventions for protection of fundamental rights, and only 82% of them know that justice reform is strongly supported by the European Union.
- 49.2% of the offline sample admit that 'property right' does not apply at all, and only 1.7% believe it applies too much.
- 40.2% of the online sample also claim that the 'property right' is not enforced at all and about 1.6% that are heavily enforced. The perceptions of both samples regarding this right are very similar
- Over 60% of the offline sample perceive the right to education to be poorly implemented or poorly implemented, while the online sample

**“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor
për të drejtat e njeriut”**

of 9.3% perceive it as 'not implemented at all', and 38.7% think 'enough'.

- Over 40% of both champions had the perception that 'human dignity and equality' in Albania is poorly implemented, and only a small percentage of about 2% claim to be highly implemented.
- 49.5% of the offline sample perceive that there is 'no achievement' in terms of respect for fundamental rights and 54.1% also perceive that there is 'no achievement' in terms of 'strengthening democracy and the rule of law'. Over 80% of the offline sample results in the boundary of a highly pessimistic perception between little and no achievement in meeting the membership criteria made by their country.
- About 16.4% of the online sample think there is 'no achievement' for areas such as approximation of EU legislation and 35.2% believe there is no 'no achievement' for criteria such as 'institutional stability and political stability'.
- 63.8% of the offline sample and 72.1% of the online sample share the same opinion, seeing developments over the last five years in terms of protecting human rights by the Albanian state as 'low achievements'.
- 63.2% of the offline sample is not aware that there is a Law on 'Protection from Discrimination' and 66.5% also do not know that there is a Law on Information. Approximately 10% of the online sample are not aware of the above mentioned legal instruments.
- 47.2% of the offline sample and 49.15% of the online sample see a dependency between advancing the country in the EU and improving their personal economic situation.
- 60.5% of the offline sample and 55.8% of the online sample see dependence between the country's EU advancement and law enforcement and protection of personal rights.
- 65.8% of the offline sample admit that they have received differential treatment from public institutions in one form or another and only

34.2% of them claim that they have not been treated differently. 64.8% of the online sample claim that they were not treated differently and about 35.2% admit that for one of the reasons listed they felt differentiated treatment

- Only 8.3% of the offline sample and 6.5% of the online sample admitted to have complained about differential treatment by public institutions.
- 81.1% of the offline sample admit to have thought of leaving the country. 77.5% of respondents belonging to the LGBTI community state that they want to leave. 83.3% of the Roma and Egyptian community also stated that they want to leave.
- 74.1% of respondents in the field stated that they want to leave asylum seekers.
- 91.3% of field respondents admit that the reason for leaving is economic, as 80% admit that the reason is lack of respect for human rights and freedoms or 57% of them identify as cause and violence.

Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi European
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuara
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e tabelave

Tabela 1: Qarku i të anketuarve	21
Tabela 2: Zonat e të anketuarve	21
Tabela 3: Kategoritë e të anketuarve	22
Tabela 4: Lista e akteve ndërkombëtare.....	28
Tabela 5: Gjinia e të anketuarve.....	50
Tabela 6: Grupmosha e të anketuarve	51
Tabela 7: Statusi i punësimit	52
Tabela 8: Kostot që mund të ketë Shqipëria nga integrimi në BE	70
Tabela 9: Përfitimet që mund të ketë Shqipëria nga integrimi në BE	70
Tabela 10: Interesi i kampionit të studimit mbi institucionet e BE-së.....	87
Tabela 11: Njohuri mbi institucionet e Bashkimit European (kampioni offline).....	87
Tabela 12: Njohuri mbi institucionet e Bashkimit European (kampioni online).....	87
Tabela 13: Vlerësimi i politikave të BE-së (kampioni offline)	88
Tabela 14: Vlerësimi i politikave të BE-së (kampioni online)	88
Tabela 15: Fushat e informacionit rreth BE-së (kampioni offline)	88
Tabela 16: Fushat e informacionit rreth BE-së (kampioni online)	89

“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Lista e figurave

Figura 1: Niveli arsimor.....	51
Figura 2: Vlerësimi i njohurive rreth BE-së (kampioni offline)	53
Figura 3: Vlerësimi i njohurive rreth BE-së (kampioni online)	54
Figura 4: Perceptime mbi zbatueshmërinë e politikave (kampioni offline).....	57
Figura 5: Perceptime mbi zbatueshmërinë e politikave (kampioni online).....	57
Figura 6: Perceptime mbi zbatimin/respektimin e 4 të drejtave (kampioni offline)..	58
Figura 7: Perceptime mbi zbatimin/respektimin e 4 të drejtave (kampioni online) ..	59
Figura 8: Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe barazisë.....	60
Figura 9: Përmbushja e kriterëve të antarësimit drejt BE-së (kampioni offline).....	60
Figura 10: Përmbushja e kriterëve të antarësimit drejt BE-së (kampioni online)	61
Figura 11: Perceptime mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut	62
Figura 12: Njohuri mbi instrumentet ligjorë (kampioni offline)	63
Figura 13: Njohuri mbi instrumentet ligjorë (kampioni online).....	63
Figura 14: Lidhja e situatës ekonomike me përparimin ose regresin e Shqipërisë drejt BE-së	64
Figura 15: Zbatimi ligjit dhe mbrojtja e të drejtave me përparimin apo regresin e Shqipërisë drejt BE-së.....	65
Figura 16: Trajtimi nga institucionet publike apo nënpunësit civil.....	65
Figura 17: Niveli i ankimimit (kampioni offline & online).....	66
Figura 18: A keni menduar të largoheni nga Shqipëria?	67
Figura 19: Kategorizimi i të anketuarve që duan të largohen sipas target-grupeve ..	67
Figura 20: Format se si do të largoheshit nga Shqipëria.....	68
Figura 21: Arsyet kryesore të largimit.....	69

Hyrje

Vlerat e vërteta të një shoqërie demokratike dalin në pah kur përmirësohen kushtet e jetesës, shërbimit dhe marrin trajtim dinjitoz edhe segmentet më të margjinalizuar të shoqërisë. Përfshirja e Shqipërisë në proceset demokratizuese dhe rrugëtimi i saj drejtë integritit evropian gjithnjë e më shumë ka rritur angazhimet e institucioneve shtetërore për t’u reformuar dhe funksionuar me standardet më bashkëkohore. Vlerat themelore të BE-së përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.¹ Kjo nënkupton domosdoshmërinë për një sistem gjyqësor funksional dhe një luftë efektive kundër korrupsionit për të garantuar respektimin e të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë.

Në këtë kontekst, të drejtat njerëzore përbëjnë bazën e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes dhe respektimi i tyre nga ekzekutivi dhe institucionet shtetërore shërben për zhvillimin e një shoqërie me rend demokratik. Gjithashtu, avancimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut është detyrë e një rëndësie parësore për integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përgjatë viteve 2015-2017, Shqipëria, si një anëtare e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, ka kontribuar duke iu bashkuar nismës globale për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.² Implikimi i detyrimeve të kësaj natyre padiskutim që përfshin dhe informimin apo monitorimin nga ana e aktorëve të shoqërisë civile mbi ecurinë dhe zbatimin e bazës ligjore nga ana e institucioneve të shtetit Shqiptar.

Ky studim vjen si një analizë për t’i parë këto arritje nga një perspektivë tjetër, nga këndvështrimi qytetar dhe ai i grupeve të margjinalizuara. Studimi tenton t’i jap përgjigje për pyetje që lidhe me:

¹ European Commission, *Albania 2019 Report*, Commission Staff working Document, SWD(2019) 215 final, COM(2019) 260 final, Brussels, 29 maj 2019, fq.14.

² United Nations General Assembly, *National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania*, A/HRC/ëG.6/33/ALB/1, Human Rights Council, working Group on the Universal Periodic Review, Thirty-third session, 6–17 May 2019, pg. 4

- A kanë segmente të ndryshme të popullatës si komuniteti Rom/Egjiptian, LGBTI dhe grupe të tjera të rëndësishme perceptime të njëjta ose të përafërta me pjesën tjetër të popullsisë në lidhje me integrimin e Shqipërisë drejtë BE-së, si dhe përfitimet dhe kostot që vinë nga ky proces?
- Çfarë mendon kjo pjesë e shoqërisë mbi këto procese që po zhvillohen në vend prej afro tre dekadash?
- Sa e ndjejnë këto komunitete zhvillimin e vendit të lidhur me integrimin drejt Bashkimit Europian?

Gjithashtu përmes instrumentave hulumtues të përdorur ky studim evidenton dhe hendekun e madh që ekziston midis grupeve të marginalizuara dhe pjesës tjetër të shoqërisë përsa i takon qasjes sesi e shikojnë perspektivën Europiane të vendit. Studimi është i strukturuar në tre kapituj kryesor ku ndërthuren analiza e bazës ligjore aktuale dhe gjetjet e marra nga kombinimi i pyetësorëve të realizuar në terren me ato online si dhe ekspertiza e marr nga këndvështrimi i ekspertëve. Në pjesën e parë të studimit paraqitet një reflektim mbi rëndësinë e integrimin të Shqipërisë në Bashkimin Europian, situata aktuale dhe roli thelbësor që luan zbatimi i reformës në drejtësi për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në pjesën e dytë ofrohet një panoramë e përgjithshme e kornizës ligjore dhe nivelit të zbatimit të saj, në mënyrë që të nxirret në pah situata aktuale e respektimit të disa të drejtave substanciale dhe veçanërisht e e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për katër grupe vulnerabël. Në pjesën e tretë ilustrohen gjetjet kryesore të matjes së perceptimeve në terren dhe nëpërmjet internetit, për të parë se sa i njohin qytetarët dhe grupet vulnerabël të drejtat e tyre në kuadër të procesit të integrimin të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Këto gjetje integrohen edhe me intervista të kryera me ekspertë dhe aktivistë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend, për të mundësuar kështu një perspektivë më të gjerë dhe multidimensionale. Së fundmi, studimi mbyllet me disa konkluzione kryesore dhe paraqet një sërë rekomandimesh për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe veçanërisht në fuqizimin e katër komuniteteve të vulnerabël e të marginalizuara nëpërmjet rritjes së njohurive dhe përmirësimin e realitetit me të cilin ata përballen çdo ditë.

Metodologjia e studimit

Ky studim synon të ofrojë një panoramë të perceptimeve të të rinjve në përgjithësi dhe të grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara në veçanti mbi procesin e integrimin të Shqipërisë në Bashkimin Europian, si dhe se si ata e shohin nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Studimi ka natyrë hulumtuese (exploratory) dhe rezultatet nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar, duke qënë se gjetjet reflektojnë vetëm mendimet e pjesëmarrësve në sondazh. Për realizimin e këtij studimi është përdorur një metodologji mikse. Analiza cilësore ka dy funksione kryesore:

- Së pari, u identifikuan dhe analizuan raporte dhe vlerësime periodike mbi respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, të publikuara nga aktorë të ndryshme shtetëror dhe joshetëror në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, gjatë harkut kohor 2018-2019.

- Së dyti, u realizuan 10 intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktivistë për të drejtat e njeriut dhe përfaqësues të institucioneve publike, të cilët janë të angazhuar në fushën e integrimin europian në Shqipëri. Intervistat u fokusuan tek opinionet e këtyre aktorëve rreth nivelit të informimit të të rinjve mbi proceset integruese të vendit në Bashkimin Europian, si dhe mbi nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut.

Analiza sasiore u bazua tek hartimi, pilotimi dhe administrimi i dy pyetësorëve: (i) një pyetësor online i cili targetonte të rinjtë në përgjithësi në nivel kombëtar, i kombinuar me (ii) një pyetësor i plotësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në terren në pesë qarqe të vendit, i cili targetonte specifikisht katër grupe vulnerabël dhe të marginalizuara. Pyetësorët (shih shtojcat 2 dhe 3) përbëhen nga pyetje të hapura dhe të mbyllura, të cilat janë të ndara në tre seksione, përkatësisht: (i) të dhëna të përgjithshme; (ii) njohuri mbi Bashkimin Europian; dhe (iii) njohuri mbi integrimin e Shqipërisë në BE.

- Pyetëtori në format elektronik (online) u publikua në portalin Historia Ime dhe u shpërnda në mënyrë të shpeshtë në rrjetet sociale të portalit. Ai u plotësua nga N = 122 pjesëmarrës, përgjatë periudhës korrik – nëntor 2019.

- Pyetëtori në terren (offline) u administrua në pesë qarqe, përkatësisht Tiranë, Durrës, Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë. Qëllimi ishte të matej perceptimi veçanërisht i të rinjve pjesë e katër grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara, përkatësisht gra dhe vajza, pjesëtarë të komunitetit LGBTI, pakicat Rome dhe Egjiptiane, si dhe persona me aftësi të kufizuara. Ky pyetësor u plotësua nga N = 301 pjesëmarrës, gjatë periudhës gusht-shtator 2019, duke ndjekur teknikën e ortekut (snowball). Kjo teknikë mundësoi identifikimin e të anketuarëve në zonat rurale dhe urbane.

Pyetësorët e realizuar kanë patur tre objektiva kryesorë: Së pari, analizimi dhe diferencimi i rezultateteve të pyetësorëve në kampionin e targetuar në terren me atë të plotësuar në formatin online. Së dyti, një vlerësimi i përgjithshëm i të dy kampionëve mbi njohuritë rreth proceseve integruese të vendit dhe Bashkimit Europian në tërësi, si dhe aspektet mbi të cilat ata janë të interesuar të njohin më shumë rreth këtij procesi. Së treti, qëllimi ka qënë analizimi i perceptimit të gjëndjes aktuale të respektimit dhe zbatueshmërisë të të drejtave dhe lirive të tyre në kuadër të zhvillimeve të proceseve demokratizuese dhe integruese në vend.

Kombinimi i realizimit të pyetësorëve në terren në pesë qarqe dhe pyetësorët në format elektronik, së bashku me intervistat e realizuara me aktorë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve publike, bëri që gjetjet të ofronin një panoramë më të plotë dhe përmbajtësore.

Karakteristikat e të anketuarve

Për shkak të specifikave të studimit kampioni i të anketuarve në terren ka disa të dhëna shtesë që lidhen me shpërndarjen së tij në pesë qarqet e vendit dhe tek katër target grupet specifike të komuniteteve të margjinalizuara. Përzgjedhja e dy kampioneve³ të të anketuarve është bërë me qëllim vlerësimin e perceptimeve dhe analizimin e një qasjeje krahasuese të rezultateve. Në mënyrë më specifike, kampioni i përzgjedhur në terren kishte disa karakteristika përsa i takon kategorizimit dhe shpërndarjesë gjeografike të tij.

Tabela 1: Qarku i të anketuarve

	Tiranë	Durrës	Shkodër	Korçë	Gjirokastrë
Numri i të anketuarve	150	48	38	42	23
Numri i të anketuarve në %	50%	16%	12,5%	14%	7,5%

Kështu nga 301 të anketuar rreth 50% e të intervistuarve ishin në Tiranë dhe 50% të shpërndarë në katër qarqet e tjera (tabela 1). Përsa i takon zonës rreth 63.7% e të intervistuarve janë nga zona urbane, 7.7% nga zona periurbane, 18.3% nga zonat rurale dhe rreth 10.3% si të intervistuar që nuk mund ta klasifikojnë zonën e tyre ose pa përgjigje (tabela 2).

Tabela 2: Zonat e të anketuarve

	Urbane	Periurbane	Rurale	Nuk mund ta klasifikoj/Pa përgjigje (25+6)
Numri i të anketuarve	192	23	55	31
Numri i të anketuarve në %	63.7%	7.7%	18.3%	10.3%

Përsa i takon kategorizimit të kampionit në terren vërehet se 36.9% deklarohen të komunitetit LGBTI, 31.9% nga komuniteti Rom/Egjiptian

³ Për efekt të interpretimit do përdoren termat kampion offline për intervistuarit në terren dhe kampion online për pyetësorët e plotësuar në formatin elektronik.

dhe më pak të intervistuar janë nga kategoria persona me aftësi të kufizuara me rreth 16.3% dhe gra vulnerabël me 13.6%. Këto të dhëna nuk i disponojmë për kampionin online (tabela 3).

Tabela 3: Kategoritë e të anketuarve

	Gra vulnerabël	Me Aftësi të Kufizuara	LGBTI	Rom/Egjiptian	Tjetër
Numri i të anketuarve	41	49	111	96	4
Numri i të anketuarve në %	13.6%	16.3%	36.9%	31.9%	1.3%

1. Zhvillimet e Shqipërisë drejt proceseve integruese europiane

Anëtarësimi në Bashkimin Europian është një prioritet kombëtar dhe e vetmja alternative politike dhe ekonomike e Shqipërisë.⁴ Aspirata europiane gëzon një mbështetje ndërpartiake dhe të mbi 90% të qytetarëve. Shqipëria mori statusin e vendit kandidat për në BE në vitin 2014 dhe në prill 2018 Komisioni Europian vlerësoi rezultatet e arrira në fushën e zbatimit të agjendës reformuese dhe publikoi rekomandimin e pakushtëzuar për hapjen e negociatave. Pak muaj më vonë, Këshilli i BE vlerësoi gjithashtu pozitivisht hapat e ndërmarrë nga Shqipëria dhe përcaktoi linjën që do të ndiqej deri në qershor 2019 për të proceduar më pas me hapjen e negociatave për anëtarësim. Këshilli vendosi që Komisioni Europian mund të procedonte përgjatë kësaj periudhe një vjeçare me organizimin e takimeve shpjeguese mbi funksionimin e procesit të shqyrtimit (screening) të legjislacionit kombëtar sipas kapitujve të *acquis* për të vlerësuar shkallën e përafrimit me legjislacionin

⁴ Këshilli i Ministrave, Raportim për vitin 2018 mbi ecurinë e procesit të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, Tiranë, Janar 2019, fq. 3.

komunitar. Ky proces dypalësh i mundësoi palës shqiptare të njihët nga afër me aktet ligjore dhe politikat e BE. Ai nisi në vjeshtën e 2018 dhe aktualisht është në përfundim.

Përpos premtimit për hapjen e negociatave midis Shqipërisë dhe BE në verën e 2019, ende ky hap nuk është ndërmarrë. Në rastin e Shqipërisë, një qendrim negativ është mbajtur nga disa shtete anëtare të BE, përkatësisht Franca, Holanda dhe Danimarka. Pozicionimi i këtyre shteteve lidhet me mungesën e përparimit në fushën e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërkohë, pozicioni i Gjermanisë është disi më i balancuar. Bundestagu gjerman ka miratur një sërë kushtesh që duhet të përmbushen më parë nga Shqipëria për të avancuar drejt hapjes së negociatave. Kushti primar lidhet me përparimin e reformës në drejtësi dhe ngritjes së institucioneve kyçe të gjyqësorit. Për momentin, çështja e hapjes së negociatave është shtyrë për në maj 2020, muaj në të cilin do të mbahet edhe Samiti i Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Kroacia, vend i cili merr Presidencën gjashtë mujore të BE në 1 janar 2020. Mbetet gjithashtu për t’u parë se si do të procedohet me reformimin e procesit të negociatave, nismë kjo e ndërmarrë nga Franca, duke u bazuar në nivelin e pakënaqshëm të sistemit kushtëzues të aplikuar nga BE-ja ndaj vendeve candidate.

Nga ana e saj, Shqipëria ka ndërmarrë disa masa për të përballuar procesin e hapjes së negociatave. Së pari, është miratuar baza ligjore mbi strukturën që do të udhëheq negociatat për vendin tonë, pra VKM nr. 32/2018 “Për përcaktimin e funksioneve të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe të strukturave të shërbimit të jashtëm në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”. Së dyti, është proceduar me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE. Së treti, ndonëse me hapa të ngadalshëm, ka vazhduar puna për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së. Së katërti, ka vijuar adresimi dhe përmbushja e pesë prioriteteve kyçe, përkatësisht: (i) krijimi i një administrate profesionale dhe të depolitizuar; (ii) forcimi i pavarësisë në sistemin gjyqësor; (iii) lufta kundër

korrupsionit; (iv) lufta kundër krimit të organizuar; dhe, (v) mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, një fokus të veçantë ka patur zbatimit i reformës në drejtësi, e cila u miratua në korrik 2016. Miratimi i ligjit nr. 76/2016 parashikoi amendimin e Kushtetutës dhe një paketë prej shtatë ligjesh organike të cilat synojnë të garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe integritetin e gjyqtarëve, si dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe monitorimit të sistemit gjyqësor. Aktualisht vijon procesi i rivlerësimit (vetting) të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka filluar puna për ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë. Reforma në drejtësi ka patur një mbështetje të madhe nga BE-ja dhe SHBA dhe një Operacion Ndërkombëtar Monitorimi është angazhuar të ndjekë procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Zbatimi i suksesshëm i reformës në drejtësi do të luaj një rol thelbësor në përparimin e Shqipërisë në rrugëtimin e saj europian, si dhe do të ketë efekte pozitive në përmbushjen e katër prioriteteve të tjera.

Në fushën e të drejtave të njeriut, Shqipëria vijon të përparojë në përmbushjen e detyrimeve, ndonëse mbetet ende punë për të bërë për të garantuar denjësisht standardet europiane. Komisioni Europian ka vlerësuar pozitive hapat e ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe në luftën ndaj dhunës në familje.⁵ Aktualisht Shqipëria është në proces të marrjes së statusit të vendit vëzhgues pranë Agjencisë së të Drejtave Themelore të BE-së.⁶

2. Liritë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri

Në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, qeveria shqiptare ka këto prioritete kyçe: (i) harmonizimi i mëtejshëm i kornizës

⁵ European Commission, *Albania 2019 Report*, op.cit., fq. 22-23.

⁶ Ibid., fq. 23.

ligjore me detyrimet e ndërmarra në nivel ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut; (ii) forcimin e mekanizmave që mundësojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave; (iii) reformimin e sistemit të drejtësisë dhe luftën ndaj korrupsionit; (iv) përmirësimin e kuadrit ligjor veçanërisht përsa i përket fëmijëve, grave, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara; si dhe, (v) bashkëpunimin me shoqërinë civile në forcimin e të drejtave të njeriut.⁷

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha instrumentet ndërkombëtarë kryesorë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe angazhohet në zbatimin e tyre në rang kombëtar. Prej vitit 2009 ajo është gjithashtu pjesë e mekanizmit të Raportimit Periodik Universal pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ky është një mekanizëm raportimi vullnetar, ku shtetet pjesëmarrëse raportojnë çdo pesë vjet hapat e ndërmarrë në adresimin e sfidave për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në nivel kombëtar.

Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e kuadrit ligjor, politik dhe institucional kombëtar dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto instrumenta ligjorë ndërkombëtar. Gjithsesi, raportet e publikuara nga Komisioni Europian nënvizojnë se mbetet ende punë për të bërë për zbatimin e plotë të këtyre angazhimeve.⁸ Një sfidë më vete mbetet fakti që është shumë e vështirë të ndërmerret një vlerësim i thelluar mbi nivelin e përmbushjes së angazhimeve të marra në fushën e të drejtave të njeriut, përsa kohë që mungojnë të dhënat dhe monitorimi i vazhdueshëm. Mungesa e analizave të kësaj natyre krijon pashmangshmërisht pengesa në hartimin e analizave dhe raporteve periodike.

Në të njëjtën linjë me Komisionin Europian janë dhe raportet e publikuara nga OKB-ja, ku vërehet që institucionet e ngritura për mbrojtjen dhe

⁷ United Nations General Assembly, *National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania*, Human Rights Council, Working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/wG.6/33/ALB/1, Thirty-third session, 6–17 Maj 2019, fq. 19.

⁸ European Commission, *op.cit.*, fq. 22.

promovimin e të drejtave të njeriut mbeten ende të pafuqishme për të përmbushur misionin e tyre, me infrastrukturë që ka nevojë për investime të mëtejshme, rritje të numrit të punonjësve, si dhe rritje të buxhetit përkatës për të ulur kështu varësinë nga financimet e donatorëve të ndryshëm.⁹

2.1. Aktet ndërkombëtare kryesore në fushën e të drejtave të njeriut

Në fushën e të drejtave të njeriut kemi një sërë aktesh ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar përgjatë viteve dhe që janë shndërruar më pas në ligje të brendshme. Me kalimin e kohës vet standardet kanë evoluar, ndonëse një pjesë prej këtyre akteve ndërkombëtare vazhdojnë ende të mbesin shtyllat mbi të cilat bazohet korniza ligjore e një shteti demokratik.

Këto akte ndërkombëtare mund të paraqiten në tre grupime kryesore, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë një lidhje varësie dhe së bashku përbëjnë korpusin e legjislacionit dhe standardeve madhore në fushën e të drejtave të njeriut. Si fillim kemi instrumentet e miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, ndjekur më pas nga aktet e miratuara nga Këshilli i Europës dhe së fundmi standardet e Bashkimit European. Secili prej këtyre organizmave rajonal dhe ndërkombëtar luan një rol thelbësor në promovimin e këtyre instrumenteve, për të nxitur dhe fuqizuar më tej të drejtat e njeriut në nivel lokal. Në tabelën 4 paraqitet një listë e akteve kryesore ku Shqipëria ka aderuar dhe vitin përkatës të ratifikimit.

Në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**, e nënshkruar në vitin 1948, përbën shtyllën kryesore ku bazohen ligjet e vendeve demokratikë, si dhe aktet e

⁹ United Nations, General Assembly, *Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, Human Rights Council, Working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/WG.6/33/ALB/2, Thirty-third session, 6–17 May 2019, fq. 1.

tjera ndërkombëtare, duke u shndërruar kështu në një garant për një sërë të drejtash të patjetërsueshme për çdo individ. Kjo deklaratë në nenin e saj të parë nënvizon se “[t]ë gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta”.¹⁰ Shqipëria është bërë pjesë e kësaj deklaratë në 1955, vit i cili përkon me anëtarësimin në OKB. Më pas vijohet me miratimin në 1966 të Paktit për të drejtat civile dhe politike, si dhe Paktit për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Të dy këto pakte detyrojnë vendet anëtare që të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej tyre, si p.sh. barazia përpara ligjit, liria e shprehjes, e drejta për liri dhe siguri, ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor, e drejta për arsim, e drejta për punë, etj.

Në kuadër të Këshillit të Europës, **Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) u miratua në vitin 1950 dhe shërben si ombrellë për respektimin e të drejtave themelore të njeriut në Europë. Shqipëria ratifikoi këtë konventë në 1996, fill pas anëtarësimit në Këshillin e Europës një vit më herët. Konventa shoqërohet edhe nga 16 protokolle shtesë dhe qëllimi i saj është “dhënia e një garancie ndërkombëtare në vijim të sistemit mbrojtës kombëtar, si dhe zhvillimi[t] [të] të drejtave të njeriut dhe lirive themelore sipas angazhimeve të marra nga shtetet anëtare”.¹¹

¹⁰ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e aksesueshme tek: <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20e%20Njeriut%20%281948%29.pdf>

¹¹ Kathleen Imholz & Elsa Toska, *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Manual për administratën publike*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë Prezenca në Shqipëri, Tiranë, Qershor 2016, fq. 35.

Tabela 4: Lista e akteve ndërkombëtare

Emërtimi i aktit ndërkombëtar	Viti i aderimit
Instrumentet në kuadër të OKB	
Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)	1955
Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)	1991
Protokolli I i Paktit	2007
Protokolli II i Paktit	2007
Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966)	1991
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006)	2012
Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1966)	1993
Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979)	1993
Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)	1992
Protokolli I (opsional) mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (2000)	2007
Protokolli II (opsional) për mbrojtjen e shitjes së fëmijëve, prostituimin dhe pornografinë me fëmijë (2000)	2007
Protokolli III (opsional) mbi procedurat e komunikimit (2011)	2013
Instrumentet në kuadër të Këshillit të Europës	
Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (1950)	1996
Protokolli XII i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (2000)	2004
Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1998)	2002
Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare	1999
Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje	2012
Standardet e Bashkimit Europian	
Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000)	
Direktivat për Trajtim të Barabartë e BE (2004/113/KE)	
Direktiva për Racën (2000/43/KE)	
Direktiva për Barazinë në Punësim (2000/78/KE)	
Direktiva për Barazinë Gjinore (2010/41/KE)	

KEDNJ mbron një sërë të drejtash të cilat reflektohen edhe në Kushtetutën e Shqipërisë, si liria e shprehjes, liria e pronës, e drejta për arsim, etj. Nga

njëra anë, KEDNJ i ofron qytetarit mbrojtje nga veprimet arbitrare të shtetit, ndërsa nga ana tjetër ruan një balancë midis interesave të qytetarëve dhe interesave të komunitetit.¹² Për respektimin e të drejtave të parashikuara tek KEDNJ është ngritur **Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut** (e cila njihet edhe si Gjykata e Strasburgut), e cila merr vendime në raste të shkeljes së të drejtave nga vendet anëtare. Shqipëria ka patur disa çështje të hapura pranë kësaj gjykate dhe bashkëpunimi dypalësh në tërësi vlerësohet si pozitiv. Gjatë vitit 2018 kjo gjykatë ka dhënë nëntë vendime, prej të cilave në shtatë raste Shqipëria është shpallur fajtores për mosrespektim të të drejtave themelore të njeriut, dhe veçanërisht për mosrespektim të detyrimit të mbajtjes së një procesi gjyqësor të drejtë.¹³

Ndërkohë, përse i përket standardeve të Bashkimit Europian, ndër vite Unioni ka miratuar një sërë paketash ligjore – kryesisht direktiva drejtuar vendeve anëtare - për forcimin e të drejtave të njeriut në sektorë të ndryshëm. Këto direktiva përcaktojnë standardet minimale të cilat duhet të respektohen nga të gjithë vendet anëtare dhe të përfshihen si në kuadrin ligjor kombëtar ashtu dhe në praktikat gjyqësore. Në veçanti, në vitin 2000 u miratua gjithashtu **Karta Themelore e të Drejtat e Njeriut** ku janë automatikisht anëtarë të gjithë vendet që anëtarësohen në BE. Ky dokument përcakton standardet më gjithëpërfshirëse në fushën e luftës kundër formave të ndryshme të diskriminimit.¹⁴ Duke qënë se Shqipëria nuk është ende vend anëtar në BE, ajo nuk e ka detyrimin që të harmonizojë legjislacionin e saj në këtë drejtim. Gjithsesi, aktualisht Shqipëria është në proces të përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe këto standarde po përthithen në korpusin tonë normativ.

¹² *Ibid.*, fq. 36.

¹³ European Commission, *op.cit.*, fq. 23.

¹⁴ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *Raporti Vjetor 2018*, Tiranë, 1 Mars 2019, fq.10.

2.2. Korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Korniza ligjore

Kushtetuta e Shqipërisë thekson që në preambul rëndësinë e respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut, ndaj shprehimisht aty thuhet që “populli i Shqipërisë [...] me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik dhe social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut [...] vendosim këtë Kushtetutë”. Ndërsa në pjesën e dytë të saj nënvizohet që të drejtat dhe liritë e njeriut janë në themel të rendit juridik shqiptar. Këto të drejta ndahën përkatësisht në: liri dhe të drejta personale; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Kushtetuta përcakton gjithashtu në nenin 18 se të gjithë qytetarët janë të barabartë përpara ligjit dhe se ndalohet çdo formë diskriminimi për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore apo shkaqe të tjera.

Në këtë linjë, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” shënon një hap përpara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke u mbështetur në frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe në standardet e BE.¹⁵ Ligji synon të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, si dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, duke iu referuar shprehimisht në nenin 1 një liste joshteruese të shkaqeve të mbrojtura nga diskriminimi. Ky ligj sikurse dhe politika ndaj mosdiskriminimit është në linjë me standardet e BE dhe përkatësisht me:¹⁶

- (i) Direktivën 2000/43/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”;
- (ii) Direktivën 2000/78/KE për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;

¹⁵ Ibid., fq.11

¹⁶ Ibid.

(iii) Direktivën 2004/113/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”;

(iv) Direktivën 2006/54/KE për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Aktualisht ligji për mbrojtjen nga diskriminimi has ende mangësi dhe pikërisht përsa i përket mosadresimit konceptit të diskriminimit të shumëfishtë.¹⁷ Një problematikë kryesore e këtij ligji është niveli i zbatimit të tij, dhe në mënyrë të veçantë nevojitet një trajnim i specializuar dhe i vazhdueshëm i gjykatësve dhe prokurorëve rreth përmbajtjes së këtij ligji.¹⁸

Për respektimin dhe mbrojtjen e parimeve themelore të të drejtave të njeriut, përpos Kushtetutës dhe ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, një rol po aq të rëndësishëm luajnë edhe Kodi i Punës, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Administrative, Kodi i Familjes, etj., ligje të tjera, sikurse edhe mekanizmat e brendshëm institucional.

Korniza institucionale

Në fushën e mbrojtjes së drejtave të njeriut janë aktualisht në funksion dy institucione të pavarura – përkatësisht Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) - puna e të cilëve bazohet në mandate të përcaktuar nga ligjet përkatëse, ndarje të kompetencave dhe në praktikat e tyre të punës. Ndërsa jurisdiksioni i Avokatit të Popullit përqëndrohet tek sektori publik, kompetencat e Komisionerit shtrihet si në sektorin publik dhe në atë privat.¹⁹ Problematika kryesore që hasin të dy këto institucione të pavarura mbetet zbatimi i dobët nga institucionet

¹⁷ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

¹⁸ *Ibid.*

¹⁹ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania, *op.cit.*, fq. 4-5.

publike i rekomandimeve që këto institucione adresojnë, si dhe forcimi i kapaciteteve për të menaxhuar rastet e dhunimit të të drejtave të njeriut.²⁰

Avokati i Popullit

Neni 2 i ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, përcakton misionit e këtij institucioni, specifikisht ai “mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj”. Avokati i Popullit gjithashtu luan rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Ky institucion nuk ka një natyrë vendimmarrëse por opinionbërëse.²¹

Avokati i Popullit ka një mandat të gjerë dhe aktualisht ai ka në funksion shtatë zyra rajonale në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit struktura dhe organika e këtij institucioni kanë pësuar ndryshime të shpeshta dhe aktualisht numri i punonjësve është 56. Pozicionet vakante ndërkohë janë përmbushur të gjitha. Ndonëse ka patur një rritje të buxhetit të alokuar për këtë institucion ndër vite, Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave ka theksuar se burimet njerëzore dhe financiare aktuale mbeten ende të limituara për përmbushjen e objektivave të paracaktuar.²²

Përsa i përket aktiviteteve gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit ka vijuar punën për promovimin e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të grupeve vulnerabël. Ky institucion i ka prezantuar 171 rekomandime institucioneve të administratës publike, prej të cilave 93 janë pranuar, 17 janë refuzuar, 5 nuk kanë marrë një përgjigje.²³ Ndërkohë që 56 të tjera janë ende në proces, çka nënkupton që nuk janë përmbushur ende afatet procedurale për

²⁰ European Commission, *op.cit.*, fq. 8, 24.

²¹ Avokati i Popullit, *Raporti vjetor për aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit Janar – Dhjetor 2018*, Tiranë, Maj 2019, fq. 4.

²² United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, Human Rights Council, *op.cit.*, pika 4.

²³ Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 6.

t’i konsideruar si të pranuar apo të refuzuara nga institucionet përkatëse. Numri i rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga institucionet ka pësuar një ulje në krahasim me një vit më parë, ndaj nevojitet një qasje më pozitive dhe sistematike në adresimin e tyre.²⁴

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se KMD është autoriteti përgjegjës për “mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”. Veprimtaria e këtij institucioni të pavarur udhëhiqet nga Plani Strategjik 2018-2021 dhe vizioni i tij është: “Të jetojmë në një shoqëri ku promovohen parimet e barazisë, mundësitë dhe shanset e barabarta”.²⁵

KMD ka tre zyra rajonale funksionale në Shqipëri dhe synimi është pikërisht garantimi i mbulimit të të gjithë territorit me shërbimet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, sikurse dhe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe aksesit të qytetarëve.²⁶ Gjatë vitit 2018, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka patur një rritje të numrit të stafit, por ende burimet njerezore dhe financiare nuk janë të mjaftueshme për një institucion të pavarur i cili garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut.²⁷

Përsa i përket aktiviteteve, gjatë vitit 2018 Komisioneri ka ndjekur gjithsej 287 çështje, prej të cilave 271 janë prej ankesave dhe 16 çështje ex-officio (prej të cilave 205 raste janë paraqitur gjatë po të njëjtit vit ndërsa 82 janë të mbartura prej 2017).²⁸ Gjatë vitit 2018 është vënë re një rritje e numrit të ankesave të paraqitura pranë KMD në krahasim më një vit më parë, me një rritje prej 15%. Një pjesë e konsiderueshme e ankesave, 232 të tilla,

²⁴ European Commission, *op.cit.*, fq. 23-24.

²⁵ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *Raporti Vjetor 2018*, W, 1 Mars 2019, fq. 4.

²⁶ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21, *op.cit.*, pika 30.

²⁷ *Ibid.*, pika 32.

²⁸ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *op.cit.*, fq. 29.

janë paraqitur nga individë, dhe më pak nga organizata apo grupe personash.²⁹ Gjithashtu, ky institucion mori pjesë në 66 çështje gjyqësore.

Aktualisht kuadri ligjor për ndalimin e gjuhës së urrejtjes është në linjë me standardet ndërkombëtare dhe gjatë 2018 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar tre raste të referuara diskriminimi mbi baza gjinore dhe orientimi seksual.³⁰ Përpos aktiviteteve ndërgjegjësuese të ndërmarra deri më tani, nevojitet një intensifikim i punës në këtë drejtim për të mbuluar gjerësisht edhe zonat suburbane apo rurale.

2.3. Progresi në zbatimin e disa të drejtave substanciale në kontekstin shqiptar

2.3.1 E drejta e pronës

E drejta e pronës është një e drejtë themelore e njeriut dhe ajo garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë. Prona është e pacënueshme dhe institucionet shtetërore mund të parashikojnë me ligj shpronësime vetëm për interesa publike kundrejt një shpërblimi përkatës.

Çështja e pronave mbetet një problematikë komplekse në Shqipëri, e cila ka hasur një tejzgjatje në kohë për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit në mënyrë korrekte, humbjes së dosjeve, tejzgjatje të procesit të shqyrtimit të vetdeklarimeve, etj.³¹ Në veçanti, moszbatimi apo zvarritja e zbatimit të vendimeve të gjykatave në lidhje me kthimin apo kompensimin e pronarëve përbën ende një problem sistemik i cili nuk ka arritur të gjejë zgjidhje.³² Në këtë drejtim, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka dhënë një vendim pilot në çështjen Manushaqe Puto kundër Shqipërisë, ku është konstatuar shkelje nga institucionet shtetërore.³³

²⁹ Ibid., fq. 31.

³⁰ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

³¹ Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 40-42.

³² Ibid., fq. 40.

³³ Imholz & Toska, *op.cit.*, fq. 91.

Përpos këtij vendimi, aktualisht përpara kësaj gjykate rezultojnë 572 raste në pritje të një gjykimi dhe shumica prej tyre lidhen pikërisht me të drejtën e pronësisë dhe zhvillimin e një procesi të rregull ligjor në këtë drejtim.³⁴

Programi i qeverisë për vitet 2017-2021 nënvizon se do të ketë një ndërhyrje reformuese në drejtim të së drejtës së pronës, ku i gjithë zinxhiri i shërbimeve publike për regjistrimin, shpronësimin dhe kompensimin e pronës do të rishikohet rrënjësisht, për të mundësuar kështu shërbime cilësore, profesionale dhe në kohë për të gjithë qytetarët. Ndërkohë, raporti i progresit të reformave në kuadër të integritimit në BE ka nënvizuar se gjatë vitit 2018 nuk ka patur asnjë avancim përse i përket përmirësimit të kuadrit ligjor në lidhje me të drejtën e pronës.³⁵ Ai thekson se procesi i regjistrimit të titujve të pronësisë në rang kombëtar është akoma në vijim dhe nevojitet që të përshpejtohen hapat nga organet përkatëse për t'a përfunduar në kohë.

Në fund të vitit 2018 u miratua ligji për themelimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila unifikon institucionet ekzistuese në një të vetëm, çka pritet të rrisë efikasitetin dhe mirëkoordinimin. Gjatë po të njëjtit vit Agjencia e Trajtimit të Pronës ka proceduar me vlerësimet financiare të personave që gëzojnë të drejtën e kompensimit, si dhe ka proceduar me lëshimin e lejeve të legalizimit të objekteve të paligjshme.³⁶ Fondi për kompensimin e pronës është rreth 700 milion euro, prej të cilave 17 milion euro janë disbursuar.³⁷ Vijueshmëria e këtij procesi varet drejtpërdrejtë nga alokimi i buxhetit përkatës dhe çdo parashikim në këtë drejtim është i vështirë.

2.3.2 E drejta për arsim

Kushtetuta mbron të drejtën e çdo qytetari për t'u arsimuar. Arsimi i mesëm në institucionet publike është falas dhe i hapur për të gjithë, ndërsa

³⁴ European Commission, *op.cit.*, fq. 27-28.

³⁵ *Ibid.*

³⁶ Këshilli i Ministrave, *op.cit.*, fq. 19.

³⁷ European Commission, *op.cit.*, fq. 27-28.

ai universitar kushtëzohet vetëm nga kriteret e aftësisë individuale. Gjithashtu, ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, garanton të drejtën kushtetuesë për arsim për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi.

Aktualisht Shqipëria shpenzon 2.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për arsimin.³⁸ Përpos faktit që ky nivel është tepër i ulët në krahasim me vendet e tjera europiane, ai nuk mundëson zbatimin e duhur të Strategjisë Kombëtare për Arsimin Para-Universitar 2014-2020, ku ky i fundit ka për qëllim pikërisht të ofrojë një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.³⁹

Për të mundësuar një rritje të aksesit në arsim të fëmijëve në situata vulnerabiliteti apo marginalizimi, qeveria alokon çdo vit një fond specifik për tekste mësimore falas, etj. Gjithsesi këto incentiva nuk kanë mundur të përballojnë nevojën për një ndërhyrje më të gjerë dhe sistematike. Në fakt vihet re se së paku 30% e fëmijëve nga komuniteti rom nuk mund të ndjekin shkollën për arsye ekonomike, mungesë të mbështetjes nga institucionet shtetërore, si dhe për arsye të diskriminimit në shkollë.⁴⁰ Gjithashtu, këta fëmijë hasin edhe barriera të tjera si mungesa e certifikatave të lindjes dhe vaksinave, mungesa e informacionit apo distanca e konsiderueshme nga shkolla me e afërt.⁴¹ Ndërkohë gjatë vitit 2018, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në analizë 93 ankesa në fushën e arsimit ku pjesa kryesore e këtyre ankesave i referohej “mospërrjashtimit nga tarifat e studimit të kategorive të studentëve që vijnë

³⁸ United Nations, General Assembly, *Summary of Stakeholders’ submissions on Albania. Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, Human Rights Council, Working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/WG.6/33/ALB/3, Thirty-third session, 6-17 Maj 2019, pika 23.

³⁹ Ibid., pika 23.

⁴⁰ Ibid., pika 24.

⁴¹ United Nations, General Assembly, *Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, *op.cit.*, fq. 6.

nga shtresat sociale në nevojë, moskthim përgjigjesh nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, etj”.⁴²

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit pranë OKB-së nënvizon gjithashtu fenomenin e braktisjes së shkollës nga vajzat, sidomos për ato që vijnë nga grupet e pakicave kombëtare, dhe vecanërisht nga komunitetet rome dhe egjiptiane.⁴³ Shkalla e regjistrimit në shkollë e vajzave mbetet më e ulët se e djemve dhe nevojitet një ndërhyrje nga institucionet përkatëse për të lehtësuar aksesin në arsimin e detyrueshëm.⁴⁴

Si përfundim, e drejta për arsim falas në Shqipëri përballet ende me një sërë sfidash, duke filluar që nga zbatimi i legjisllacionit, tek mekanizmat lehtësues, mundësitë financiare dhe infrastruktura e dobët.⁴⁵

2.3.3 E drejta për kujdes shëndetësor

E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë kushtetuese e qytetarëve shqiptar dhe të gjithë shtetasit e gëzojnë në mënyrë të barabartë këtë të drejtë nga shteti. Aktualisht qeveria shqiptare shpenzon rreth 2.6% të PBB për sistemin shëndetësor, çka shënon një nivel të ulët shpenzimi në krahasim me shtete të tjera me karakteristika të njëjta me Shqipërinë.⁴⁶ Investimet në sistemin shëndetësor vazhdojnë të jenë të ulëta dhe mungesa e alokimeve financiare ndikon drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve dhe në zbatimin në kohë dhe në mënyrë efikase të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016-2020. Gjithashtu, vërehet një mungesë e theksuar e mjekëve specialist në spitalet rajonale dhe zonat rurale për arsye të emigrimit, si dhe pajisjeve mjekësore në spitalet rajonale.⁴⁷

⁴² Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 43.

⁴³ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 27.

⁴⁴ *Ibid.*, pika 23, 27.

⁴⁵ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders' submissions on Albania, *op.cit.*, fq. 5.

⁴⁶ *Ibid.*, pika 19.

⁴⁷ Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 42.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave nënvizon se Shqipëria ndeshet me një mbikëqyrje të kufizuar të ambienteve spitalore, e cila është një efekt i drejtpërdrejtë i buxhetit të ulët.⁴⁸ Problematikat të tjera në fushën e shëndetësisë lidhen me infrastrukturën e dobët, distancën e konsiderueshme të qendrave të kujdesit shëndetësor (sidomos për personat pjesë e komunitetit rom)⁴⁹, si dhe mungesës së aksesit në shërbime të specializuara.⁵⁰ Në veçanti, raporti i publikuar në kuadër të mekanizmit të Raportimit Periodik Universal thekson se personat LGBTI kanë hasur problematika në lidhje me aksesin e plotë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, si dhe janë përballur me një cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara për shkak të sjelljeve diskriminuese dhe stigmatizuese të personelit.⁵¹ Gjithashtu, raportohet se “personat transgjiner janë përballur me diskriminim apo refuzim të shërbimeve nga stafi mjekësor bazuar në identitetin e tyre gjinor”.⁵²

Gjatë 2018, Avokati i Popullit ka analizuar 87 ankesa në fushën e kujdesit shëndetësor dhe arsyet kryesore lidhen me trajtimin mjekësor jo konform standarteve, mungesa në medikamente, burokracira, mungesa e protokolleve mjeksore, etj.⁵³ Nga këto 87 ankesa, 30 prej tyre janë zgjidhur në favor të qytetarit.

2.3.4 Të drejtat e fëmijëve

Në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve qeveria shqiptare ka shënuar hapa përpara përsa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor dhe të politikave. Aktualisht është duke u zbatuar edhe Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, e cila synon të krijojë kushtet e favorshme për zhvillimin e fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të

⁴⁸ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 23.

⁴⁹ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, pika 19.

⁵⁰ *Ibid.*, pika 19.

⁵¹ *Ibid.*, pika 20.

⁵² *Ibid.*

⁵³ Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 42.

gjitha proceset. Kjo agjendë krijon një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe është një linjë me aktet ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar. Gjithsesi, në terma praktik, deri më tani pak nisma janë ndërmarrë për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në agjendën në fjalë.⁵⁴

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ndjek një qasje ndërsektoriale me synimin që të forcojë mbrojtjen dhe të adresojë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve. Mbetet ende për t’u adresuar çështja e miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e kësaj qasje ndërsektoriale.⁵⁵ Një tjetër aspekt problematik është fakti që ndonëse ligji parashikon ngritjen e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, vetëm një pjesë e bashkive kanë ngritur tashmë strukturat përkatëse, duke kontribuar kështu në fragmentimin e mëtejshëm të punës.⁵⁶ Ndërkohë është rishikuar edhe ligji mbi statusin civil i cili synon të lehtësojë procedurat për rregjistrimin e fëmijëve, duke ndikuar në eliminimin e problematikavë të hasura veçanërisht nga fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane. Ky rishikim i mundëson gjykatave të ndërhyjnë në rregjistrimin e fëmijëve, në sistemin e të dhënave për rastet kur ka të dhëna të pasakta, dhe pritjet të ndikojë edhe në uljen e numrit të qytetarëve pa nënshtësi.⁵⁷

Nga pikëpamja institucionale është përmirësuar mandati i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, ndonëse mungon ende alokimi i përshtatshëm i burimeve njerëzore dhe i burimeve financiare për të përmbushur objektivat e paracaktuar për mbrojtjen e fëmijëve.⁵⁸

⁵⁴ European Commission, *op.cit.*, fq. 29.

⁵⁵ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 36.

⁵⁶ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, pika 31.

⁵⁷ United Nations, General Assembly, *Report of the Working Group on the Universal Periodic Review* Albania*, Human Rights Council, Universal Periodic Review, A/HRC/42/4, Forty-second session, 9–27 September 2019, Agenda item 6, pika 12.

⁵⁸ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, fq. 6.

Problematike mbetet ende çështja e ndarjes së shërbimeve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve midis disa institucioneve shtetërore. Rast ilustrues është ai i mbrojtjes sociale dhe i mbrojtjes së fëmijëve, i cili zbatohet nga dy institucione të ndryshme. Kjo qasje çka nuk lejon mundësinë e ndjekjes së një qasjeje gjithëpërfshirëse në adresimin e këtyre të drejtave, rrezikon të çënojë zbatimin në mënyrë koherente të të gjitha masave të parashikuara në dokumentat strategjike dhe nga kuadri ligjor, si dhe rezultatet mbeten në varësi të nivelitë koordinimit të punës dhe vullnetit përkatës të këtyre instucioneve.⁵⁹

2.4. Progresi në zbatimin e të drejtave themelore të katër grupeve vulnerabël

Në këtë seksion do të analizojmë progresin e arrirë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të katër grupeve vulnerabël, përkatësisht barazia gjinore, personat e komunitetit LGBTI, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e komuniteteve rome dhe egjiptiane. Ndonëse për të katër këto grupe ekzistojnë strategjitë dhe planet e veprimit përkatëse, apo legjislacion në linjë me standardet ndërkombëtare, situata mbetet ende problematike në nivel zbatimi. Problematikat kryesore lidhen me mungesën e miratimit të akteve nënligjore, mundësimi i burimeve të mjaftueshmë financiare, si dhe mbledhja e të dhënave statistikore për të monitoruar vijueshmërinë e situatës në kohë reale.

2.4.1 Barazia gjinore

Qeveria shqiptare ka vijuar të zbatojë Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, e cila ndjekë një qasje multi-sektoriale në adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe përmban një sërë masash për parandalimin e dhunës. Në raportin e dorëzuar në kuadër të mekanizmit për Rishikimin Periodik Universal,

⁵⁹ European Commission, *op.cit.*, fq. 29.

qeveria ka deklaruar se strategjia në fjalë ka në dispozicion objektivat, indikatorët dhe buxhetet përkatëse për çdo aktivitet.⁶⁰ Gjithsesi, progresi i zbatimit të saj është vlerësuar i ngadaltë për shkak të mungesës së financimit.⁶¹ Në këtë linjë vazhdon gjithashtu zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014-2020, Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020, si dhe Planit të Veprimit për Mbështetjen e Grave Sipërmarrëse 2014-2020.

Në fushën e legjislacionit janë shënuar hapa pozitivë gjatë vitit 2018. Është rishikuar ligji nr. 47/2018 mbi masat kundër dhunës në familje, i cili tashmë është në linjë me Konventën e Stambollit dhe me Konventën për Eleminimin e të gjitha Formave të Dhunës kundër Grave. Ky ligj ka përmirësuar përkufizimin ligjor të dhunës në familje,⁶² ka forcuar masat mbrojtëse për të dhunuarat, dhe nevojitet tashmë një zbatim i vazhdueshëm dhe koherent, duke patur parasysh që dhuna familjare mbetet një sfidë serioze.⁶³

Një problematikë e ngritur nga Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit kundër Grave mbetet ende dhuna me bazë gjinore dhe raportimi i ulët i këtij fenomeni.⁶⁴ Gjithashtu, ky komitet nënvizon se zbatueshmëria e mekanizmit të referimit të dhunës dhe numri i strehave për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë të pamjaftueshme. Numri i mekanizmit të referimit të dhunës ka arritur në 60 nga 61 bashki që ka Shqipëria dhe nevojiten masa shtesë për t’a bërë këtë mekanizëm funksional. Gjithashtu,

⁶⁰ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania, *op.cit.*, pika 43.

⁶¹ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

⁶² United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, fq. 6.

⁶³ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

⁶⁴ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 30.

pushteti lokal duhet të investojë më shumë në aktivitete ndërgjegjësuere dhe alokim të fondeve për prioritetet me bazë gjinore.⁶⁵

Gjatë vitit 2018 janë verifikuar 4.951 raste të dhunës në familje dhe në 1.914 prej këtyre rasteve janë referuar në prokurori për procedim penal.⁶⁶ Gjithsej janë arrestuar 608 autorë të dyshuar për ushtrim të dhunës dhe 77 prej tyre janë burgosur; ndërkohë që janë raportuar edhe 541 raste të tjera për vepra të tjera penale që lidhen me marrëdhëniet familjare.⁶⁷

Organizata të ndryshme të shoqërisë civile ofrojnë mundësi strehimi për viktimat e dhunës me bazë gjinore, ndonëse kapacitetet e tyre dhe financimet në dispozicion janë të limituara. Vlen të përmendet që gratë që janë pjesë e grupeve vulnerabël përballen me barriera të tjera shtesë që nuk mundësojnë përfitim të këtyre shërbimeve.⁶⁸ Në veçanti, gratë e komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë informacionin e mjaftueshëm mbi të drejtat e tyre dhe se si mund të përfitojnë nga këto shërbime.⁶⁹

Gjatë 2018 janë miratuar gjithashtu ligjet mbi ndihmën ligjore falas dhe strehimin social, të cilët tashmë duhet të zbatohen në mënyrë efektive për të siguruar fuqizimin e grave. Përfituesit parësor të këtyre ligjeve janë viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës seksuale, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, etj. Gjithsesi, nevojitet që të ndërmerren aktivitete për promovimin e ndërgjegjësimit ligjor të grave, sidomos midis grupeve vulnerabël.

Për të fuqizuar me tej positionin ekonomik të grave, janë miratuar disa akte nënligjore mbi të drejtën për të tërhequr ndihmën ekonomike. Ndonëse parimisht ky është një hap pozitiv, në nivel konkret zbatimi i

⁶⁵ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania, *op.cit.*, fq. 5-7.

⁶⁶ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

⁶⁷ Ibid.

⁶⁸ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 30.

⁶⁹ European Commission, *op.cit.*, fq. 28.

këtyre masave ka qënë i limituar për gratë dhe vajzat pjesë e grupeve vulnerabël dhe të margjinalizuara që jetojnë në zonat sub-urbane dhe rurale.⁷⁰ Ende në ditët e sotme gratë vazhdojnë të jenë kryesisht të angazhuara në tregun informal të punës, duke mospërfitur asnjë mbrojtje sociale. Gjithashtu, hendeku i nivelit të pagave mbi bazë gjinore vazhdon të ekzistojë. Kjo problematikë është ngritur nga organizma të ndryshëm ndërkombëtar dhe mbetet ende për t’u adresuar.

Përsa i përket të drejtave për pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe politike, është shënuar një rritje pozitive pas rishikimit të Kodit Elektorale për një përfshirje prej 50% të kandidatëve në listat shumë-emërore. Gjithsesi, nevojitet që të shënohet përmirësim në përfshirjen e grave që janë pjesë e grupeve vulnerabël apo të margjinalizuara, duke eliminuar pengesat ekzistuese si p.sh. dokumentacioni nga regjistri civil apo barrierat fizike.⁷¹

Si përfundim, Shqipëria ka vazhduar të shënojë progres në përmirësimin e kuadrit ligjor kombëtar rreth barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, duke u përafuar me standardet e përfshira në aktet ndërkombëtare. Sfidë mbetet ende niveli i zbatimit në praktikë, vijueshmëria e këtij zbatimi, sikurse dhe mundësia e burimeve të mjaftueshme financiare për të adresuar në mënyrë korrekte problematikat e sipërpërmendura.

2.4.2 Të drejtat e personave LGBTI

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI 2016-2020 ndjek një qasje ndërsektoriale që synon të sigurojë garantimin e të drejtave të barabarta të kësaj kategorie në shoqëri dhe të luftojë kundër të gjitha formave të diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.⁷² Plani parashikon një sërë masash për të adresuar sfidat e diskriminimit dhe

⁷⁰ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, fq. 7.

⁷¹ Ibid.

⁷² Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020*, Mars 2016, fq. 14.

integrimin e tyre, si dhe për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit publik dhe mbrojtjen e të drejtave të këtij komuniteti. Zbatimi i këtij plani aktualisht është i pamundur për shkak të mungesës së buxhetit për zbatimin e masave të parashikuara.⁷³ Ndërsa, kuadri ligjor në fuqi ndalon diskriminin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor dhe synimi është që kuadër të përmirësohet me tej, duke u vendosur në linjë me standardet ndërkombëtare.⁷⁴

Në jetën e përditshme personat LGBTI vazhdojnë të përballen me një sërë sfidash përsa i përket aksesit në punësim, shëndetësi, edukim dhe strehim. Ndërkohë që sfida primare mbetet diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Gjatë 2018, 10 persona u detyruan të kërkonin azil për shkak të diskriminimit, ndërkohë që niveli i ndërgjegjësimit të përgjithshëm dhe pranimit të personave LGBTI mbetet i ulët, sidomos në zonat rurale.⁷⁵ Një rol të konsiderueshëm për të drejtat e këtij komuniteti e luajnë organizatat e shoqërisë civile, ndonëse edhe këto shërbime janë të brishta për shkak të mungesës së vazhdueshme të burimeve financiare. Vet streha për personat LGBTI financohet nga donatorë të huaj dhe ofron kujdesje, mbështetje dhe advokim për këtë kategori qytetarës të pastrehë.⁷⁶

Raporti i hartuar në kuadër të mekanizmit të Rishikimit Periodik Universal nënvizon se ka një mungesë të theksuar të njohurive dhe aftësive për të ndihmuar personat LGBTI. Oficerët e policisë dhe pikat e kontaktit në ministrinë e linjës janë trajnuar për parandalimin e diskriminimit. Gjithsesi, avarsisht numrit të trajnimeve apo publikimit të manualeve, rezulton që forcat e policisë mbeten gjerësisht të painformuara dhe patrajnuara mbi të

⁷³ European Commission, *op.cit.*, fq. 30.

⁷⁴ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21, *op.cit.*, pika 120.

⁷⁵ European Commission, *op.cit.*, fq. 30.

⁷⁶ Ibid.

drejtat e personave LGBTI, sikurse dhe psikologët në shkollat e arsimit parauniversitar.⁷⁷

Shpesh personat e komunitetit LGBTI përballen me qasje homofobike, bulizëm dhe gjuhën e urrejtjes. Kjo gjuhë haset edhe në median tradicionale dhe atë online, dhe në disa raste ka patur për si pjesëmarrës aktiv figura publike. Evidencat tregojnë që të rinjtë transgjnorë ndihen të detyruar të braktisin shkollën për këto qasje homofobike, si dhe për shkak të diskriminimit dhe izolimit në shoqëri.⁷⁸ Ndërkohë, rastet e krimeve të raportuara të cilat bazohen në gjuhën e urrejtjes janë të ulët në numër dhe mungojnë instrumentet për mbledhjen e të dhënave për këtë kategori veprash kriminale.⁷⁹

Së fundmi, kuadri ligjor në fuqi nuk mundëson ende martesën midis personave të së njëjtës gjini, të drejtën për ndërhyrje kirurgjikale për rickaktimin gjnor për personat transgjnorë, si dhe të drejtën e vetëvendosjes në lidhje me integritetin trupor për personat interseks.⁸⁰

2.4.3 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 synon të përmirësojë cilësinë e jetës dhe përfshirjen efektive të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në jetën politike, sociale dhe kulturore në Shqipëri. Aktualisht plani është në zbatim dhe është shoqëruar edhe nga disa përmirësime të kuadrit ligjor përkatës. Përmirësimet janë hasur në drejtim të miratimit të akteve nënligjore në lidhje me shërbimet publike, eliminimi i barrierave infrastrukturore, mbledhja e të dhënave statistikore dhe miratimi i ‘gjuhës së shenjave’.⁸¹ Gjithsesi, ky kuadër ligjor mbetet ende pjesërisht në linjë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të

⁷⁷ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, pika 5.

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Ibid.

⁸⁰ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 6.

⁸¹ Ibid., pika 123.

Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe nuk është shënuar progres në ratifikimin e Protokollit Opsional të kësaj konvente nga institucionet shqiptare.⁸²

Në jetën e përditshme personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të hasin barriera të shumëfishta në lidhje me aksesin në arsim, kujdes shëndetësor, pjesëmarrje në vendimmarrje apo mobilitet për shkak të barrierave infrastrukture,⁸³ ndonëse kuadri ligjor në fuqi parashikon të drejtën për të përfituar nga këto shërbime. Vetëm gjatë vitit 2018 institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në dorëzim dhe shqyrtuar 131 ankesa për këtë kategori.⁸⁴ Numri i ankesave është më i lartë në krahasim me atë të një viti më parë dhe arsyet lidhen me mosmarrjen e përfitimeve të parashikuara nga legjislacioni (sepse nuk janë miratuar aktet nënligjore). Një shembull ilustrues është detyrimi ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, sipas ligjit nr. 7995/1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, ndërkohë që në nivel praktik ligji nuk zbatohet për arsye të vakumit ligjor përsa përket kategorisë së punëdhënësve.⁸⁵

Ndërkohë Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së nënvizon në raportin e vlerësimit të situatës në Shqipëri se personat me aftësi të kufizuara hasin vështirësi të konsiderueshme në lidhje me “zbatimin e legjislacionit ekzistues, probleme strukturore të sistemit e kujdesit shoqëror, dhe qasje të dobët në arsim cilësor dhe në punësim”.⁸⁶ Zbatimi i munguar i këtij kuadri ligjor dhe politikë është pasojë e mungesës së buxhetimit nga të gjithë sektorët, mungesa e miratimit të akteve nënligjore dhe e monitorimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, thekson raporti i zyrës së OKB në Shqipëri.⁸⁷ Një rast ilustrues është ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe

⁸² European Commission, *op.cit.*, fq. 29-30.

⁸³ Ibid.

⁸⁴ Avokati i Popullit, *op.cit.*, fq. 49.

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, pika 39.

⁸⁷ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 41.

aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ku vonesat në miratimin e akteve nënligjore ka penguar drejtpërdrejtë përmirësimin e situatës në terren. Komisioni Europian në progres raportin e vitit 2019 thekson se aktualisht janë miratuar vetëm tre prej këtyre akteve nënligjore.⁸⁸

Duke u fokusuar tek aksesit dhe cilësia e arsimimit të fëmijëve PAK, vërehet se përpos përpjekjeve të institucioneve shtetërore për të siguruar në arsim gjithpërfshirës, situata në terren paraqitet ende e vështirë. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në vitin akademik 2017-2018 ishte 4336, ku vetëm 15% e të cilëve ndjekin shkolla të specializuara.⁸⁹ Vështirësitë më të mëdha hasen nga fëmijët që nuk dëgjojnë. Ndërkohë që numri i qendrave rezidenciale është 11, prej të cilave gjashtë janë publike dhe pesë private.⁹⁰ Përgjatë vitit të fundit është vërejtur një rritje e numrit të mësuesve mbështetës, si dhe ka patur një përmirësim në infrastrukturë dhe teknologji për fëmijët me aftësi të kufizuara.⁹¹ Në këtë drejtim nevojitet ende një vëmendje nga autoritetet për të investuar në infrastrukturën teknologjike me çmime të aksesueshme nga familjet, si dhe për të përmbushur të gjitha nevojat. Çka mbetet shqetësuese është fakti që fëmijët PAK vazhdojnë ende të përballen me diskriminimin në shkollë dhe në shoqëri.⁹²

Aktualisht është duke u rishikuar sistemi i vlerësimit të aftësive të kufizuara. Ligji për ndihmën ekonomike parashikon një skemë të re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar sociale, e cila po pilotohet në dy njësi administrative në Bashkinë Tiranë.⁹³ Gjithsesi, mbetet ende problematikë

⁸⁸ European Commission, *op.cit.*, fq. 29-30.

⁸⁹ *Ibid.*

⁹⁰ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 125.

⁹¹ United Nations General Assembly, National report submitted in accordance ëith paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21, *op.cit.*, pika 126.

⁹² United Nations, General Assembly, Summary of Stakeholders’ submissions on Albania, *op.cit.*, pika 41.

⁹³ United Nations, General Assembly, Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *op.cit.*, pika 122.

që kërkonë zgjidhje fakti që bashkitë nuk kanë mundësi financiare për të ofruar shërbimet e kujdesit shoqëror për personat PAK.⁹⁴

Si përfundim, sfida parësore mbetet nevoja për një vëmendje më e madhe në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe në zbatimin e tyre në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme nga autoritetet shtetërore. Gjithashtu, këto institucione duhet të mbledhin dhe ruajnë të dhëna statistikore, të cilat mundësojnë monitorimin efektiv të zbatimit të kuadrit ligjor, si dhe identifikojnë në kohë nevojat se ku duhet të ndërhyet për të përmirësuar situatën. Sikurse për kategoritë e tjera të marginalizuara, mungesa e buxhetimeve do të vazhdojë të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së personave PAK.

2.4.4 Komunitetet Rome dhe Egjiptiane

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është struktura përgjegjëse për koordinimin e punës në kuadër të integritit të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Së pari, vazhdon të zbatohet Plani i Veprimit 2016-2020 dhe në fund të vitit 2018 u zhvillua dialogu i katërt i politikave për një rritje të përfshirjes së këtyre pakicave. Ky dialog ofroi një sërë rekomandimesh, të cilat pritet të zbatohen përgjatë dy viteve të ardhshme.

Hapa pozitivë janë hedhur në drejtimin e edukimit të këtyre komuniteteve dhe veçanërisht përsa i përket rregjistrimit në arsimin e detyrueshëm, ofrimin e librave falas dhe transportin në zonat e largëta.⁹⁵ Rregjistrimi në arsimin e detyruar të fëmijëve rom është aktualisht 66%, ndërsa vetëm 43% e tyre arrijnë të mbarojnë shkollën.⁹⁶ Përpos kushteve të vështira ekonomike, problematikë e vazhdueshme mbetet hendeku midis fëmijëve rom dhe egjiptian dhe pjesës tjetër që jetojnë në të njëjtën zonë, sikurse dhe niveli i segregimit të tyre në institucionet arsimore. Nevojitet një ndërhyrje sistematike dhe e qëndrueshme nga institucionet shtetërore për adresimin e këtyre sfidave, dhe në këtë drejtim duhet përmendur që edhe

⁹⁴ Ibid., pika 40.

⁹⁵ European Commission, *op.cit.*, fq. 31.

⁹⁶ Ibid.

vet ministria përgjegjëse duhet të forcojë më tej kapacitetet,⁹⁷ për të mundësuar përmbushjen e objektivave të përcaktuar në planin e veprimit 2016-2020.

Gjatë vitit 2018 u miratua ligji për strehimin social, i cili parashikon një kuotë prej 5% për banesa sociale për komunitetet rome dhe egjiptiane. 424 familje përfituan gjatë po të njëtit vit nga nisma për përmirësimin e kushteve të banimit, ndonëse duhet të ndërmerren ende hapa për një adresim të mëtejshëm të çështjes së konsolidimit të të drejtave të pronës.⁹⁸ Ndërkohë u rishikua edhe ligji për regjistrin civil, i cili mundësoi regjistrimin e 157 fëmijëve nga këto dy komunitete.⁹⁹

Në fushën e punësimit, komunitetet rome dhe egjiptiane shënojnë një nivel shumë të ulët të pjesëmarrjes, ku mbi 56% e forcës punëtore janë të papunë, ndërsa rreth 62% e atyre të punësuar operojnë në sektorin informal.¹⁰⁰ Akses i këtyre dy komuniteteve në shërbimet publike në përgjithësi mbetet i limituar. Ndaj nevojitet një rishikim i strategjisë së punësimit për të targetuar në mënyrë korrekte këtë problematikë, si dhe një qasje e strukturuar për t'i mundësuar këtij komuniteti një akses dhe përfitim nga skema e sigurimit shëndetësor.

3. Analiza e gjetjeve

3.1. Analiza e Seksionit A: “Demografia”

Një përshkrim i detajuar i kampionit të të intervistuarve në terren është bërë në kuadër të metodologjisë së studimit. Disa elementë shtesë do të trajtohen në një qasje krahasuese për të dy kampionët në lidhje me: gjininë, grupmoshën, arsimimin dhe statusin e punësimit. Përsa i takon

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ Ibid., fq. 22-23, 31.

⁹⁹ Ibid., fq. 31.

¹⁰⁰ Ibid.

gjinisë, në kampionin në terren vërehet ruajtja e një balance në numrin e të intervistuarve të përfshirë në studim. Sikurse ilustron në tabelën 5, të dhënat tregojnë se 49.5% e të intervistuarve janë femra ose 149 nga 301 persona të intervistuar, 47.9% (ose 144 persona) i të intervistuarve janë meshkuj dhe 2.6% (8 persona) janë deklaruar si pjesë e kategorisë ‘tjetër’. Ndërkohë të dhënat e marra nga pyetësorët e plotësuar online na rezultojnë që të anketuarat femra janë më shumë, me 66.4% të numrit dhe vetëm 33.6% janë meshkuj. Në këtë studim na rezultoi që anketueset femra janë më të gatshme për të plotësuar pyetësor online, gjë e cila mund të lidhet sa me përdorimin e rrjeteve sociale dhe internetit aq dhe me predispozitën për të dhënë kontribut.

Tabela 5: Gjinia e të anketuarve

<i>Formati offline (301 të anketuar në terren)</i>			
Gjinia	Femra	Meshkuj	Tjetër
numri	149	144	8
%	49,50%	47,90%	2,60%
<i>Formati online (122 të anketuar online)</i>			
Gjinia	Femra	Meshkuj	Tjetër
numri	81	41	0
%	66.4%	33.6%	-

Një e dhënë interesante dhe e pritshme e kampionit online lidhet me grupmoshën ku na rezultojnë se të anketuarit online janë në maxhorancë të rinj, ku rreth 62.3% e tyre i përkasin grupmoshës nga 18 në 24 vjeç, ndërkohë tek kampioni offline rreth 35.5% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve i përkasin grupmoshës 25-30 vjeç. Kjo karakteristikë e kampionit online lidhet me përdorimin në masë nga të rinjtë e rrjeteve sociale dhe internetit.


“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Tabela 6: Grupmosha e të anketuarve

<i>Formati offline (301 të anketuar në terren)</i>				
Grupmosha	18-24 vjeç	25-30 vjeç	31-35 vjeç	mbi 35 vjeç
Numri	90	107	62	42
Në %	29.9%	35.5%	20.6%	14%
<i>Formati online (122 të anketuar)</i>				
Grupmosha	18-24 vjeç	25-30 vjeç	31-35 vjeç	mbi 35 vjeç
Numri	76	24	11	11
Në %	62.3%	19.7%	9%	9%

Përsa i takon nivelit arsimor (fig. 1) tek kampioni offline vërehet qartë se gati 60% e numrit të të intervistuarve kanë 9 klasë shkollë ose më pak dhe pjesa më e madhe e tyre i përket komunitetit rom dhe egjiptian dhe personave me aftësi të kufizuara, ndërkohë tek kampioni online 67.2% deklarojnë se janë me arsim të lartë. Nëse i referohemi një konteksti më të gjërë, sikurse përmendet në seksionin 2.4.4, vërehet një rritje e numrit të fëmijëve rom në arsimin e detyruar, por që e kanë të pamundur të vazhdojnë dot shkollën me tej për arsye ekonomike. Ky konstatim lidhet dhe me rezultatet e studimit tonë ku ky komunitet ka përqindjen më të ulët të viteve të arsimimit. Gjithashtu dhe me arsim të mesëm rezulton 20% e kampionit offline, pra një përqindje jo e vogël.

Figura 1: Niveli arsimor



Një e dhënë tjetër që vlen të analizohet është statusi i punësimit, i cili ilustron tek tabela 7. Në formatin e kampionit offline kemi gjithsej 64.8% të intervistuar që deklarojnë që nuk kanë një punë, ndërkohë tek formati i kampionit online na rezulton se 46.7% janë të punësuar. Ky nivel i lartë papunësie lidhet me mungesën e arsimit/kualifikimit të kampionit offline dhe pamundësinë e tyre ekonomike për kualifikime të nevojshme për marrjen e një zanati. Këto dhe shumë arsye të tjera si diskriminimi, mungesa e informacionit etj. jua vështirësojnë mundësitë për të gjetur hapësirën e tyre në tregun e punës. Sikurse flasin dhe rezultatet, aksesimi në punësim mbetet problematik, pavarësisht se baza ligjore përpiqet të favorizojë fuqizimin ekonomik të grupeve të marginalizuara dhe në veçanti të grave dhe vajzave.


Tabela 7: Statusi i punësimit

<i>Formati offline (301 të anketuar në terren)</i>					
Statusi i punësimit	I papunë	Punëkërkuess	I punësuar	I paiterësuar për punë	Pa përgjigje
Numri	100	95	95	7	4
%	33.2%	31.6%	31.6%	2.3%	1.3%
<i>Formati online (122 të anketuar)</i>					
Statusi i punësimit	I papunë	Punëkërkuess	I punësuar	I paiterësuar për punë	Pa përgjigje
Numri	29	31	57	5	
%	23.8%	25.4%	46.7%	4.1%	

3.2. Analiza e seksionit B: “Njohuri mbi Bashkimin European”

Një pjesë e rëndësishme e këtij studimi ishte dhe realizimi i një vlerësimi të përgjithshëm mbi njohuritë rreth proceseve integruese të vendit dhe Bashkimit European në tërësi, si dhe aspektet mbi të cilat ata janë të interesuar të njohin më shumë rreth këtij procesi. Pyetjes se *si do i vlerësonit njohuritë tuaja rreth institucioneve të BE-së*, të intervistuarit nga kampioni offline deklarojnë në masën 55-60% se nuk kanë *aspak njohuri* rreth institucioneve kryesore të Bashkimit European (fig. 2); gjithashtu, në përqindje jo të vogël janë dhe ata që janë përgjigjur të cilët kanë *pak njohuri*, përafërsisht rreth 20%. Kjo e dhënë tregon se gati 80% e kampionit janë pa njohuri ose me njohuri minimale dhe vetëm 20% e tyre grupohen si njohës mesatar, të mirë apo shumë të mirë të institucioneve. Ky rezultat lidhet me shkallën e ulët të arsimimit, mungesën e aksesit në informacion, si dhe mund të lidhet me faktin që deri më tani nuk ka patur një strategji shtetërore për komunikimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi integrimin në BE për të gjithë popullatën.


Figura 2: Vlerësimi i njohurive rreth BE-së (kampioni offline)



Nëse shikojmë të dhënat e marra nga kampioni online (fig. 3) vërejmë së njohuritë që ata deklarojnë në masë mbi 60% janë pak a shumë në nivelin mesatar dhe njohuri të mira. Shkalla më e lartë e arsimimit, punësimit,

aksesi dhe përdorimi i teknologjisë tek ky kampion i ka mundësuar më shumë informacion rreth institucioneve të BE-së. Sikundër deklarojnë dhe të intervistuarit nga organizata të shoqërisë civile, aktivistë për të drejtat e njeriut dhe përfaqësues të institucioneve publike pjesa më e madhe e punës është bërë nga OJF-të shqiptare dhe targetimi ka qënë i orientuar kryesisht për një kategori personash me më shumë mundësi, si p.sh. ata që jetojnë në kryeqytet, apo institucionet arsimore të vendit si gjimnaze, universitete, etj.

Figura 3: Vlerësimi i njohurive rreth BE-së (kampioni online)



Më tej kur të intervistuarit pyeten se për cilin nga institucionet e mësipërme do të kishit interes të merrnit më shumë informacion rezultatet e të dy kampioneve treguan se institucionet për të cilën do të donin të informoheshin më shumë njohuri ishin Gjykata Europiane dhe Parlamenti European dhe më pak të interesuar ishin për Këshillin European dhe Komisionin (tabela 10 tek shtojca 1).

Kur pyetja lidhej me vlerësimin e politikave më konkrete të Bashkimit European përgjigjet tek kampioni offline treguan se përafërsisht për çdo njëjën nga politikat rreth 21% e numrit të të anketuarve i vlerësonte *si aspak të rëndësishme*. Mungesa e rëndësisë të këtyre politikave për këta të

anketuar lidhej dhe kur pyeteshin për fusha si demokracia, respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe pakicave në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante, vetëm 23.9% e kampionit offline i cilësonin shumë të rëndësishme. Ky rezultat i ulët reflekton jo vetëm mungesën e njohjes, por dhe mosbesimin tek efica e përmbushjes së këtyre politikave dhe ndikimi që mund të kenë në jetën e tyre, ndaj dhe përgjigjet e tyre tregojnë indiferencë dhe mosbesim. Gjithashtu, ky rezultat mund të lidhet me faktin e mosdiferencimit të konceptit nga shtet anëtar në shtet aspirant dhe ku është pozicioni i Shqipërisë në këtë proces. Ndryshe paraqitet situata tek kampioni online i cili i vlerëson në masën mbi 45% të gjitha politikat, madje demokracinë dhe respektimin e të drejtave themelore i vlerëson si shumë të rëndësishme në masën 57.4% (tabela 13 dhe 14 tek shtojca 1).

Ndryshimi i perceptimit mbi rëndësinë e politikave dhe proceseve integruese midis dy kampionëve është dukshëm i kundërt. Gjithashtu, kampioni offline shpreh një mungesë të theksuar interesi, pasi rreth 50% e tyre nuk kanë interes për të marrë informacion mbi aspekte të caktuara të historisë, politikave të BE-së apo proceseve integruese etj. Në krahasim me kampionin offline, të pyeturit përmes internetit për aspekte si *“Procesi i negociatave dhe anëtarësimi në BE”* apo *“BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor”* tregojnë në masën 92% se janë të interesuar të marrin informacion për këto çështje (tabela 15 dhe 16 tek shtojca 1).

3.3. Analiza e seksionit C: “Njohuri mbi integrimin e Shqipërisë drejt BE-së”

Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij studimi lidhet me analizimin e perceptimit të gjendjes aktuale të respektimit dhe zbatueshmërisë të kuadrit ligjor mbi të drejtat dhe liritë e qytetarëve, në kuadër të proceseve demokratizuese dhe integruese të vendit drejt Bashkimit Europian. Pyetjes nëse jeni pro untegrimit të Shqipërisë drejt BE-së, të dy kampionët në masën **88 – 90%** i janë përgjigjur ‘**PO**’, pra të dy kampionët ndajnë të

njëjtin këndvështrim pozitiv për integrimin e vendit. Sikundër edhe në studime apo raporte të tjera edhe këto rezultate evidentuan dakortësinë për rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit European, pra pavarësisht kategorizimit apo mungesës së njohurive pjesa dërrmuese e të pyeturve duan integrimin e vendit.

Interesant është fakti dhe njëkohësisht rezultatet lidhen ngushtë dhe vërtetojnë çka është thënë tek pyetja 5: Pra kampioni offline nuk ka njohuri për BE, dhe rrjedhimisht për MSA-në, ndaj kur ata pyeten se: *“A e dini se Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit me Bashkimin European dhe Shtetet Anëtare të tij, (1 prill 2009) e detyron Shqipërinë të respektojë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Europë të Re”* janë shprehur me ‘**JO**’ 39.2% e tyre. Ndërkohë kampioni online ka thënë ‘**PO**’ në masën 80.3%, dhe kjo shpjegohet me faktin që kanë më shumë mundësi për akses në informacion dhe për shkak të arsimimit më të lartë. Vetë fakti që e kanë plotësuar pyetëtorin nëpërmjet një postimi në një faqe interneti apo në median sociale tregon që kanë më shumë mundësi për të marrë informacion.

E njëjta llogjikë si tek pyetjet e mësipërme është ndjekur edhe tek pyetja 11 (fig. 4 dhe 5), ku duket qartë që kampioni offline nuk ka informacion për pothuajse asnjë nga ato 4 fjali të shkruara përveç reformës në drejtësi e cila del ‘**PO**’ me 40% dhe ‘**NUK E DI**’ me 41% - për reformën flitet tërë ditën në media ndaj dhe përgjigjet janë të përafërta. Gjithashtu, shqetësuese është fakti që 22% (janë shprehur **JO**) dhe 46.8% e të intervistuarve në kampionin offline deklarojnë që nuk e dinë që Shqipëria ka ratifikuar pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore, pra rreth 68.8% janë pa informacion për pohime kaq bazike.

“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Figura 4: Perceptime mbi zbatueshmërinë e politikave (kampioni offline)






Figura 5: Perceptime mbi zbatueshmërinë e politikave (kampioni online)



Të dhëna interesante marrim kur të intervistuarit pyeten se si do e vlerësonin zbatimin e respektimit të të drejtave që lidhen me të drejtën e pronës; të drejtën për arsim; të drejtën për kujdes shëndetësor dhe të drejtën për informim në Shqipëri. Rezultatet e pasqyruara në figurën 6 tregojnë që 49.2% e kampionit të të intervistuarve në terren shprehen se kjo e drejtë nuk zbatohet fare, dhe vetëm 1.7% e tyre besojnë se zbatohet shumë. Rezultate të larta për moszbatimin e kësaj të drejte ka dhe kampioni online (fig. 7), ku rreth 40.2% janë shpresur se nuk *zbatohet aspak* dhe rreth 1.6 që zbatohen shumë. Sikundër është analizuar dhe më lartë tek seksioni 2.3.1 e drejta e pronës është një nga të drejtat që vijon të mos gjejë zbatim edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri. Perceptimet tek të dy kampionet në lidhje me këtë të drejtë janë pothuajse njësoj

Figura 6: Perceptime mbi zbatimin/respektimin e 4 të drejtave (kampioni offline)




Ndryshe është perceptimi mbi të drejtën për arsim ku kampioni online në masën 9.3% shprehet se nuk *‘zbatohet aspak’*, ndërkohë që *‘mjaftueshëm’* mendojnë rreth 38.7% e të anketuarve (fig. 7). Perceptimi i kampionit offline mbi të drejtën për arsim rezulton se është në masën 30.2% që *‘nuk zbatohet aspak’*, madje po të konsiderojmë dhe përgjigjen *‘zbatohet pak’*

“Perceptime mbi integritimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

na rezulton se mbi 60% e këtyre të intervistuarve kanë perceptim negativ të mos gëzimit të kësaj të drejte themelore (fig. 6). Ky perceptim negativ i kampionit offline lidhet dhe me kontekstin vetjak, të cilët aksesin për arsim e kanë minimal. Siç u analizua dhe më lartë më shumë së gjysma e kampionin ishin me arsim 9 vjeçar.


Figura 7: Perceptime mbi zbatimin/respektimin e 4 të drejtave (kampioni online)



Nivele të larta të perceptimit negativ të moszbatueshmërisë së të drejtës lidhet dhe me të drejtën e informimit. Kampioni offline pohon se gati 43.5% nuk e gëzon të drejtën e informimit. Ndërkohë dhe shifra prej 20% e kampionit online tregojnë për mungesë të këtij shërbimi apo të drejtës për informim të qytetarëve nga institucionet publike dhe burokracisë që ato kanë. Në tërësi perceptimi për zbatimin e të drejtave është shumë negativ tek kampioni offline sesa tek kampioni online.


Lidhur me perceptimin mbi dinjitetin njerëzor dhe barazinë, nisur nga eksperiencia personale, si të intervistuarit në terren dhe ata online e vlerësojnë respektimin dhe zbatimin e këtyre të drejtave në Shqipëri pak a shumë njësoj. Pothuajse mbi 40% e të dy kampionëve kishin të njëjtin perceptim që dinjiteti njerëzor dhe barazia në Shqipëri zbatohet pak, dhe vetëm një përqindje e vogël rreth 2% besonin se zbatohet shumë (fig. 8).

Figura 8: Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe barazisë



Një aspekt i rëndësishëm ishte analizimi i këndvështrimit të të dy kampionëve përsa i takon perceptimit të tyre në lidhje me *përmbushjen e kriterëve të antarësimit nga ana e Shqipërisë*. Rezultatet ishin befasuese dhe njëkohësisht dëshmonin diferencën e ndjeshme ndërmjet dy kampionëve. Kështu të anketuarit në terren për 6 kriteret e poshtëshënuara në marzhin nga 49.5-54.1% shprehnin se nuk kishte ‘*aspak arritje*’ përsa i takon përmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e Shqipërisë (fig. 9). Pothuajse në një masë të konsiderueshme përafërsish 30% ishin dhe ata që pohonin se kishte ‘*pak arritje*’, pra më shumë se 80% e kampionit ishin në kufirin e një perceptimi tejet pesimist ndërmjet *aspak* dhe *pak arritje* të bëra nga vendi i tyre. Pra zhvillimet në vend dhe proceset integruese të perceptuara nga grupet e marginalizuara janë tejet pesimiste dhe kjo tregon hendekun dhe vështirësitë që hasin këto grupe në jetën e tyre të përditshme duke mos parë përmirësim të kushteve të tyre.


Figura 9: Përmbushja e kriterëve të antarësimit drejt BE-së (kampioni offline)



“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Nga krahu tjetër, një optikë më pozitiviste e të parit të përmbushjeve të këtyre kritereve vjen nga kampioni online ku për të 6 kriteret e pyetura rezultojnë se rreth 16.4% e të anketuarve mendojnë që nuk ka ‘*aspak arritje*’ për fusha si përafrimi i legjislacionit me BE-në dhe nivel më të lartë të përgjigjeve që nuk ka ‘*aspak arritje*’ është për kriterin ‘*Stabilitet institucional dhe Stabilitet politik*’ me rreth 35.2% (fig. 10). Gjithashtu, niveli i atyre që besojnë se ka arritje shumë të mira është më i lartë tek kampioni online ku variojnë nga 11.5% për respektimin e të drejtave themelore dhe 4.9% tek stabiliteti politik; ndërkohë, tek kampioni offline niveli i përgjigjeve është 0.3-1.3% e atyre që besojnë se ka arritje shumë të mira.

Figura 10: Përmbushja e kritereve të antarësimit drejt BE-së (kampioni online)




Në tërësi, niveli i perceptimit për përmbushjen e kritereve është i ulët pasi të dy kampionët në përqindje të ndryshme por relativisht të larta janë të pakënaqur me zhvillimet e deri tanishme në përmbushjen e këtyre kritereve.

Kur të anketuarit në terren dhe online pyeten se si i shikojnë zhvillimet e bëra gjatë 5 viteve të fundit në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut na rezultojnë se të dy kampionet ndajnë të njëjtin opinion pak a shumë negativ. Kështu kampioni offline në masën 38.9% mendon se është bërë ‘*pak*’ dhe rreth 24.9% e tyre mendojnë se është bërë ‘*disi*’, pra në një masë prej 63.8% mendojnë ‘*arritje të pakta*’. Po kështu kampioni online 37.7%

është bërë ‘pak’ dhe 34.4% është bërë ‘disi’, në total rreth 72.1% mendojnë ‘arritje të pakta’ (fig. 11).


Figura 11: Perceptime mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut



Ndërkohë pyetja 18 fokusohet tek fakti nëse të anketuarit kanë ose jo dijeni për instrumentet ligjorë si konventa, deklarata apo dokumenta të tjerë mbi të drejtat e njeriut në nivel europian dhe kombëtar. Kjo pyetje e cila është më specifike ka patur si qëllim analizimin e perceptimit të të intervistuarve në një kuadër më të ngushtë. Sikundër pritej dhe tek kjo pyetje përgjigjet tregojnë mungesën e madhe të informacionit dhe njohurive dhe diferencen midis dy kampioneve si dhe nevojën për ti kushtuar vëmendje këtyre grupeve të shoqërisë për ti përfshirë në iniciativa për informimin e tyre. Sikundër duket qartë dhe nga figura 12, shqetësuese është fakti që jo vetëm dokumentat ligjor europian nuk njihen nga më shumë se gjysma e kampionit në terren, por dhe si ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i vitit 2010 apo ligji për informim i vitit 2014 nuk njihet nga 63.2% dhe 66.5% e të intervistuarve në terren. Pra pavarisisht faktit që këto dy ligje ka disa vite që janë në fuqi dhe janë thelbësore pikërisht për këtë shtresë të popullsisë, pjesë më e madhe e tyre nuk dinë që këto ligje ekzistojnë.


“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Figura 12: Njohuri mbi instrumentet ligjorë (kampioni offline)




Kjo situatë dëshmon për nevojën urgjente që duhet të marrin institucionet shqiptare dhe aktorët e shoqërisë civile që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut për informimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të marginalizuara për t'i njohur dhe për të kërkuar zbatimin e tyre. Ndryshe është panorama tek kampioni online, sikundër tregojnë dhe të dhënat e figurës 13 një pjesë shumë e vogël përafërsisht 10% e kampionit online nuk ka njohuri për instrumentet ligjorë të poshtëpërmëndur. Kjo tregon dhe një herë hendekun që ekziston midis grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Figura 13: Njohuri mbi instrumentet ligjorë (kampioni online)



Kur të intervistuarit pyeten se sa e konsiderojnë të lidhur situatën ekonomike me përparimin ose regresin e Shqipërisë drejt BE-së rezultatet tregojnë se rreth 31.9% e kampionit offline e konsiderojnë të lidhur, dhe gjithashtu rreth 15.3% e konsiderojnë shumë të lidhur pra rreth 47.2% e kampionit shohin varësi mes avancimit të vendit në BE dhe përmirësimit të situatës ekonomike personale (fig. 14). Gjithashu edhe kampioni online shikon në masën 31.15% të lidhur dhe rreth 18% e tyre si shumë të lidhur pra rreth 49.15% e totalit të kampionit e shohin këtë varësi. Si konkluzion mund të pohojmë se të dy kampionet ndajnë të njëjtin mendim.


Figura 14: Lidhja e situatës ekonomike me përparimin ose regresin e Shqipërisë drejt BE-së



E njëjta gjë vlen edhe kur tentohet të analizohet perceptimi nëse e shikojnë apo jo të lidhur zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave me përparimin e Shqipërisë drejt BE-së. Rezultatet tregojnë se rreth 24.6% e kampionit offline e konsiderojnë të lidhur dhe gjithashtu rreth 35.9% e konsiderojnë shumë të lidhur; pra, rreth 60.5% e kampionit shohin varësi mes avancimit të vendit në BE dhe zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave personale. Gjithashu edhe kampioni online shikon në masën 27.9% të lidhur dhe po kaq shumë të lidhur; pra, rreth 55.8% e totalit të kampionit e shohin këtë varësi. Mund të pohojmë që të dy kampionet ndajnë pak a shumë të njëjtin mendim. Theksojmë se kampioni online në masën 31.9% e shikon si shumë të lidhur pra ka besim dhe bindje se avancimi i Shqipërisë drejt BE-së do të sjell më shumë progres në forcimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave (fig. 15).


“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Figura 15: Zbatimi ligjit dhe mbrojtja e të drejtave me përparimin apo regresin e Shqipërisë drejt BE-së




Një këndvështrim interesant vjen nga të dy kampionët kur pyeten nëse janë trajtuar ndryshe nga nënpunësit e institucioneve publike. Për kampionin offline të dhënat tregojnë që rreth 65.8% e tyre në një formë apo tjetër kanë marrë trajtim të diferencuar dhe vetëm 34.2% e tyre kanë pranuar se nuk janë trajtuar ndryshe. 25.6% e të intervistuarit e lidhin trajtimin e diferencuar me përkatësinë etnike, dhe rreth 9% e tyre pranojnë se janë trajtuar ndryshe për shkak të orientimit seksual dhe/apo identitetit gjinor. Ndërkohë të dhënat e marra nga kampioni online tregojnë të kundërtën, ku rreth 64.8% e të anketuarve pohojnë se nuk janë trajtuar ndryshe dhe rreth 35.2% pranojnë se për një nga arsyet e renditura kanë ndjerë trajtim të diferencuar. Të anketuarit online pranojnë në masën 9.8% se ka patur më shumë se një arsye për trajtimin e tyre ndryshe nga nënpunësit e institucioneve publike (fig. 16).

Figura 16: Trajtimi nga institucionet publike apo nënpunësit civil



Në vijim kur kampioni offline pyetet nëse u janë drejtuar autoriteteve përkatëse për evidentimin e këtij trajtimi rreth 62.1% kanë zgjedhur alternativën JO, një pjesë e konsiderueshme rreth 29.6% nuk prononcohen dhe vetëm 8.3% kanë pranuar se kanë bërë ankesë. Tek kampioni online 6.5% e tyre kanë bërë ankesë dhe 93.5% kanë thënë JO (fig. 17). Niveli i ankimit tek të dy kampionët është shumë i ulët referuar përqindjes së deklaramit tek Pyetja 21 nga ana e tyre për trajtim jo korrekt të marrë nga nënpunësit e institucioneve shtetërore.

Figura 17: Niveli i ankimit (kampioni offline & online)




Nga 25 të anketuarit e kampionit offline që pranuan se kanë bërë ankesë, vetëm 22 prej tyre kanë cilësuar institucionet si vijon: 8 të intervistuar pranojnë se ju janë drejtuar organizatave të shoqërisë civile, 6 të intervistuar Policisë së Shtetit, 6 autoriteteve lokale dhe vetëm 1 i intervistuar Komisionerit kundër Diskriminimit, gjithashtu një i intervistuar e konsideron dhe rrethin shoqëror si “autoritet” ku mund të drejtosh ankesën. Po kështu tek kampioni online 6 të anketuar i janë drejtuar institucioneve si: Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave

“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Personale; Departmenti i Administratës Publike; Policia Shtetit, organeve të drejtësisë dhe qendrës ‘Streha’.


Në pyetësor ka disa pyetje specifike të realizuara vetëm me kampionin offline. Kështu, kur ky kampion u pyet: “Nëse keni menduar të largoheni nga Shqipëria?” rezultatet ishin befasuese. Gati 81.1% e të intervistuarve pranorin se kishin menduar të largoheshin nga vendi (fig. 18).

Figura 18: A keni menduar të largoheni nga Shqipëria?



Në një analizë më të detajuar të të dhënave përsa i takon numrit të të anketuarve që duan të largohen, sipas kategorizimit në grupe, na rezulton se komuniteti LGBTI dhe ai rom kanë numrin më të lartë të të anketuarve që deklarojnë se duan të largohen nga vendi. Kështu nga 111 të anketuar që i përkasin komunitetit LGBTI 86 prej tyre ose 77.5% deklarojnë se duan të largohen nga vendi, po kështu nga 96 të anketuar që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian 80 prej tyre ose 83.3% duan të ikin. Po të shikojmë dhe komunitetet e tjera në një masë gati mbi 85% duan të largohen (fig. 19).


Figura 19: Kategorizimi i të anketuarve që duan të largohen sipas target-grupeve



Nëse i analizojmë të dhënat se 81.1% e të anketuarve duan të largohen nga vendi në kontekstin e pyetjes 19 dhe 20, ku gati 60% e kampionit offline shikonte një lidhje mes progresit të vendit drejt BE-së dhe përmirësimit të gjëndjes ekonomike, zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave, konkludojmë në faktin që ky kampion e percepton një nivel “*në vend numëro apo regres*” në drejtim të zhvillimeve të Shqipërisë në fushën e integritimit dhe për shkak të gjëndjes ekonomike dhe jo vetëm, pjestarë e grupeve të margjinalizuara duan masivisht të largohen paçka mundësive minimale që ata kanë. Mund të themi se pavarësisht përpjekjeve dhe zhvillimeve pozitive që janë hasur në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimit të tij me standardet e përfshira në aktet ndërkombëtare, në perceptimin e kampionit nuk ka ndryshim të gjëndjes së tyre. Ajo që vërehet është fakti që kampionet në fjalë perceptojnë një nivel shumë të ulët të zbatimit të ligjit në vend. Ky është një konstatim i bërë nga shumë aktorë, çka nënkupton që ka shumë vend për t’u përmirësuar. Ky konkluzion vërtetohet edhe nga përgjigjet e pyetjes 23/2 ku 91.3% e të intervistuarve duan të largohen për arsye ekonomike.

Pyetjes *se si do të largoheshit nga vendi*, rreth 74.1% e të intervistuarve deklarojnë si *azilkërkues*. Të intervistuarit kanë zgjedhur azilin si alternativë karshi migrimit për arsye ekonomike (13.3%). Kjo tregon një konfuzion në informacionin që ata posedojnë për diferencën midis lejeqëndrimit për mbrojtje ndërkombëtare (azil) dhe lejeqëndrimit për arsye punësimi (emigrant). Një element i cili nuk qartësohet nga kjo matje e perceptimit është fakti që të anketuarit duan të ikin si azilkërkues 74.1% dhe kur pyeteshin për arsyet e largimit përgjigjet tregojnë se rreth 91.3% për arsye ekonomike (fig. 20).


Figura 20: Format se si do të largoheshit nga Shqipëria



“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Gjithashtu pak e qartë është edhe fakti që tek pyetja 23/1 vetëm 0.4% e të anketuarve kanë zgjedhur si opsionin “arsye diskriminimi” për t’u larguar nga Shqipëria, ndërsa tek pyetja 23/2 opsioni “trajtim diskriminues në shoqëri” del me 80% të 229 përgjigjeve (fig. 21). Gjithashtu shqetësuese mbeten dhe arsyet e tjera si mungesa e respektimit të lirive dhe të drejtave me rreth 80% apo dhuna me 57%.

Figura 21: Arsyet kryesore të largimit



Dy pyetjet e fundit të pyetësorit kanë të bëjnë me perceptimin që kanë të dy kampionët përsa i përket kostove dhe përfitimeve që do ketë Shqipëria në kuadër të integrimin në BE. Sikundër vërehet dhe nga rezultatet (tabela 8) dy nga kostot që pritet të ketë Shqipëria, ku të dy kampionët bien dakort, është fakti që “BE i favorizon vendet më të mëdha në kurriz të vendeve më të vogla” dhe se “BE-ja kushton para”. Ndërkohë që për kampionin offline një kosto tjetër është “Struktura e taksave në Europë nuk inkurajon zhvillimin e bizneseve të reja”, ndërsa për kampionin online cilësohet si kosto “Nivelet e larta të burokracisë dhe administratës brenda BE-së”.

Tabela 8: Kostot që mund të ketë Shqipëria nga integrimi në BE

KOSTOT	Kampioni Offline		Kampioni Online	
BE-ja kritikohet për mungesë transparence.	119	39.5%	23	18.9%
Struktura e taksave në Europë nuk inkurajon zhvillimin e bizneseve të reja.	143	47.5%	36	29.5%
BE i favorizon vendet më të mëdha në kurriz të vendeve më të vogla.	210	69.8%	71	58.1%
Nivelet e larta të burokracisë dhe administratës brenda BE-së.	90	30%	56	46%
BE-ja kushton para.	132	43.8%	59	48.4%

Përsa i takon përfitimeve dhe këtu e njëjta situatë paraqitet për të dy kampionët, të cilët vlerësojnë si përfitime “*të drejtat ligjore dhe njerëzore ...*” dhe “*punësim dhe lëvizje e lirë e qytetarëve*”. Gjithashtu kampioni offline si përfitim tjetër të rëndësishëm vlerëson “*përfitime të gjera politike dhe ligjore*”, ndërsa kampioni online e shikon në një nivel makro duke e parë si përfitim “*... përmbushjen e standardeve dhe sigurisë ndërkombëtare*”. Pra pak a shumë vlerësimi i kostove dhe përfitimeve nga të dy kampionët perceptohet njëjloj.

Tabela 9: Përfitimet që mund të ketë Shqipëria nga integrimi në BE

PËRFITIMET	Kampioni Offline		Kampioni Online	
Stabiliteti politik dhe integrim më i madh midis shteteve europiane.	40	13.3%	45	36.9%
Përfitime të gjera politike dhe ligjore.	92	30.6%	26	21.3%
Të drejtat ligjore dhe njerëzore. BE ka një angazhim të fortë ndaj të drejtave të njeriut, duke parandaluar diskriminimin dhe procesin e duhur të ligjit.	70	23.3%	58	47.5%
Punësim dhe lëvizje e lirë e qytetarëve.	125	41.5%	75	61.5%
Krijon një nivel tjetër të përmbushjes së standardeve dhe sigurisë ndërkombëtare.	34	11.3%	46	37.7%
Mundëson përthithjen më të madhe të fondeve nga BE-ja	62	20.6%	27	22.1%

3.4. Analiza e intervistave me përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë

Në kuadër të këtij studimi u realizuan 10 intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktivistë për të drejtat e njeriut dhe përfaqësues të institucioneve publike (shih listën tek shtojca 4). Qëllimi i këtyre intervistave ishte trajtimi i proceseve të integritit dhe jo vetëm nga këndvështrimi i ekspertëve, për t'i ballafaquar gjetjet e marra nga pyetësorët dhe analizat e raporteve, studimeve dhe dokumentave të tjera ligjore. Procesi i intervistimit është realizuar gjatë muajit nëntor 2019. Të intervistuarit kanë patur mundësinë që pyetjet e intervistës t'i konsultonin paraprakisht. Përmes intervistave është synuar të kuptohet më shumë mbi mendimin e ekspertëve për gjendjen aktuale dhe zhvillimet e arrira, problematikat e hasura në kuadër të integritit të Shqipërisë, etj.

Për gjatë viteve të fundit është intensifikuar përpjekja e aktorëve të shoqërisë civile për të patur në fokus të punës së tyre proceset integruese të vendit. Në pjesën më të madhe të aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile fokusi kryesor janë të rinjtë. Në këtë kontekst, një nga pyetjet e intervistës lidhej më faktin se sa janë të informuar të rinjtë për integrimin e Shqipërisë në BE. Nga analiza e intervistave rezultoi se pjesa më e madhe e të intervistuarve ndanin mendimin që të rinjtë shqiptarë kanë pak informacion mbi procesin e integritit të vendit në BE, ndërsa tek të rinjtë pjesë e grupeve të marginalizuara ky informacion është pothuajse i papërfillshëm. Sipas Gentian Elezit, “[...] të rinjtë janë pak të informuar përse i përket përmbajtjes së çfarë është BE-ja. [...] Dinë disa elementë sipërfaqësorë dhe kryesisht njohuri të marra nga media”.¹⁰¹ Në të njëjtën linjë mendimi është dhe Alba Brokaj, e cila pohon se “[...] të rinjtë shqiptarë kanë informacion të disponueshëm, por pak prej këtij informacioni është i saktë, e akoma më pak është i thelluar dhe ofron

¹⁰¹ Intervistë me Gentian Elezi, përfaqësues i Institutit Agenda dhe ekspert për çështje e Integritit dhe BE, 26 nëntor 2019.

analizë”.¹⁰² Megjithatë disa pranojnë se në nivel lokal, të rinjtë e Bashkisë Tiranë paraqesin një përqindje më të lartë të informacionit përsa i përket këtij procesi.¹⁰³ Ky konstatim na rezultoi dhe nga të dhënat që gjeneruam nga pyetësorët. Gjithashtu, sipas Françeska Muços “kjo gjë mund të shpjegohet me centralizimin e aktiviteteve, projekteve dhe informacionit në kryeqytet”¹⁰⁴. Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi “[...] nuk mund të thuhet saktësisht, të rinjtë kanë informacion kryesisht në aspektin pozitiv të hyrjes në BE, por nuk kanë informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit në BE”.¹⁰⁵

Një çështje tjetër e evidentuar nga Gledis Gjipali lidhet me faktin e “[...] mungesës në shkolla të lëndëve për Bashkimin Europian, gjë që krijon mungesë informacioni fillestar dhe të rinjtë të informohen vetëm nga çfarë media ofron [...] informacion të cunguar ose me aspekte politike ose informacione të ditës por jo çështje të thelluara të procesit të integritimit”.¹⁰⁶ Sipas ekspertëve ajo që vlen për t’u theksuar për të gjithë të rinjtë janë gjithashtu pritshmëritë *jo realiste* në lidhje me *periudhën që do t’i duhet Shqipërisë* për t’u anëtarësuar në Bashkimin Europian dhe ndikimin që ky i fundit do të ketë në mirëqenien e tyre ekonomike.

Një aspekt tjetër lidhet me pyetjen nëse qeveria shqiptare ka një strategji komunikimi për integrimin e vendit në BE. Nga përgjigjet e marra, rreth 70% e të intervistuarve pranojnë se nuk ka një dokument të tillë dhe 30% e tyre nuk kanë informacion për ndonjë strategji komunikimi. Sipas ekspertes Brokaj “mungesa e një strategjie për komunikimin e procesit, jo vetëm dëmton punën e qeverisë, kjo pasi reformat dhe aktivitetet e bëra në kuadër të procesit nuk i arrijnë qytetarit si informacion i thjeshtë për t’u kuptuar dhe informacion pa nuanca politike, por në të njëjtën kohë dëmton

¹⁰² Intervistë me Alba Brokaj, Përfaqësuese Speciale e Shqipërisë për Rininë dhe Sigurinë, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian, 25 nëntor 2019.

¹⁰³ Intervistë me Françeska Muço, përfaqësuese e Rrjetit të Profesionistëve të Rinj, 30 nëntor 2019.

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Intervistë me Robert Gajdja, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 13 nëntor 2019.

¹⁰⁶ Intervistë me Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane për Shqipërinë, 13 nëntor 2019.

punën e mëvonshme, pasi duke mos patur informacion mbi procesin, qytetarët kanë më pak shanse të jenë pjesë aktive e tij dhe të luajnë rolin e grupeve të interesit sipas temave”. Të intervistuarit pranojnë se dy dokumentat më të rëndësishëm që shprehin vizionin dhe veprimtarinë e procesit për integrimin e Shqipërisë në BE, si Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2018–2020 dhe Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015 – 2020 nuk ofrojnë informacion përsa i përket hapave, planeve, situatës konkrete të integritit të Shqipërisë në BE. Kjo gjë, pranojnë disa prej tyre, krijon shkëputje në përcjelljen e informacionit tek qytetari, duke i bërë këta të fundit indiferent dhe të painteresuar për procesin në tërësi. Ata pohojnë se pjesa dërrmuese e qytetarëve nuk janë në dijeni të ekzistencës së këtyre dokumentave që përcaktojnë rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Të dhëna dhe këndvështrime interesante marrim në lidhje me pyetjen mbi rolin dhe kontributin e OSHC-ve shqiptare në rritjen e njohurive mbi proceset integruese të Shqipërisë. Të gjithë të intervistuarit ndajnë mendimin se roli i OSHC-ve është i rëndësishëm dhe se fokusi i aktiviteteve të organizatave pavarësisht objektivave dhe misionit të tyre, në tërësi duhet të ngrihet dhe në dimensionin e integritit. Krahas informimit dhe sensibilizimit për Megi Reçin, roli dhe kontributi i Organizatave të Shoqërisë Civile lidhet gjithashtu me procese si monitorimi i zbatimit të ligjeve, strategjive, planeve të veprimit, pjesëmarrje në konsultime për ndryshime legjislative dhe prodhimi i rekomandimeve, nxitja e transparencës dhe llogaridhënies si dhe realizimi i studimeve të ndryshme.¹⁰⁷ Sipas ekspertes Brokaj, deri më tani OSHC-të kanë qënë burimi kryesor dhe më i besueshëm i shpërndarjes së njohurive për procesin e integritit. Ajo thekson se “[p]avarësisht kontributit që duhet njohur, vlen të kritikohet edhe fakti, se kjo shpërndarje njohurish duke qënë e bazuar mbi agjendën dhe projektet e donatorëve, shpeshherë i nxit OSHC-të të ndërmarrin punë në këtë fushë pa patur kapacitetet dhe ekspertizën e duhur. Në këtë rast, OSHC-të kontribuojnë në një kakofoni

¹⁰⁷ Intervistë me Megi Reçi, përfaqësuese e organizatës Civil Rights Defenders, 11 nëntor 2019.

informacioni që fokusohet vetëm në përmbajtje sipërfaqësore”.¹⁰⁸ Për Francesca Muçon “OSHC-të kanë një rol shumë të madh në rritjen e informacionit mbi procesin e integritit, por nevojitet një intensifikim më i madh i aktiviteteve të tyre. [...] Përfshirja e metodave më inovative të informimit se sa trajnimet e thjeshta është një tjetër aspekt që OSHC-të duhet t’u marrin në konsideratë për të forcuar kontributin e tyre”.¹⁰⁹

Si konkluzion, mund të themi se mungesa e një strategjie komunikimi nga ana e ekzekutivit në Shqipëri është një çështje që duhet trajtuar. Gjithashtu, ndër vite është rritur pesha e aktorëve të shoqërisë civile për t’u përfshirë më intensivisht në njohjen dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, grupeve të interesit dhe në veçanti të të rinjve mbi proceset integruese të vendit.

Një çështje tjetër e trajtuar me të intervistuarit lidhej më identifikimin e tre sfidave kryesore në lidhje me informimin e të rinjve rreth integritit në BE. Sipas të intervistuarve sfidat kryesore kanë të bëjnë me:

- Mungesa e lëndëve specifike në kurrikulat mësimore në cikle të ndryshme studimi në lidhje me Bashkimin European;
- Mungesë e burimeve, aktiviteteve të strukturuar dhe periodike, informacionit cilësor dhe analitik rreth Bashkimit European dhe procesit të integritit;
- Përdorimi i rrjeteve sociale dhe burimeve alternative për të informuar dhe qenë më pranë të rinjve;
- Sqarimi i rëndësisë së BE-së në jetën e përditshme të qytetarëve përtej përfitimeve ekonomike apo lëvizjes së lirë;
- Ndërgjegjësimi për nevojën e shfrytëzimit të mekanizmave të ndryshëm për të drejtat e njeriut që mund të përdoren për të rritur llogaridhënien e qeverive;
- Ndërgjegjësimi për nevojën e informimit të çështjeve që trajtohen nga Parlamenti dhe Komisioni European;

¹⁰⁸ Intervistë me Alba Brokaj, *op.cit.*

¹⁰⁹ Intervistë me Françeska Muço, *op.cit.*

- Mungesa e interesit për të qenë i informuar apo mungesa e kulturës së të lexuarit;
- Përqëndrimi i projekteve, aktiviteteve, zyrave të organizatave në Tiranë duke sjellë si pasojë nivel të ulët informimi dhe përfshirje të të rinjve/qytetarëve nga rrethet/zonat e tjera;
- Pjesëmarrje më e shtuar e përfaqësuesve të Bashkimit Europian në Shqipëri në universitete dhe shkolla të mesme;
- Pushteti vendor të ndërmarrë një rol më proaktiv në lidhje me promovimin e vlerave të Bashkimit Europian;
- Realizimi i një strategjie kombëtare për informim dhe komunikim duke patur në fokus edhe të rinjtë.

Ndërkohë ekspertja Keraj nënvizon se tek të rinjtë e grupeve të margjinalizuara sfidat janë të shumëfishta, të cilat lidhen me mungesën e nevojave bazike; sfida kryesore mbeten arsimimi i këtyre të rinjve, kufizimi i hapësirave për informacion, si dhe mungesa e theksuar e interesit që ata shfaqin për të njohur dhe kuptuar çështje të kësaj natyre.¹¹⁰ Për këtë arsye, nevojitet që të gjenden forma dhe mënyra të reja informimi të përshtatshme për këtë target-grup.

Një pyetje tjetër e realizuar në kuadër të këtij studimi lidhet me nivelin e informacionit që kanë të rinjtë mbi përfitimet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, si dhe përsa i përket të drejtave themelore të njeriut. Ajo që të intervistuarit konstatojnë është informacioni i përgjithshëm dhe sipërfaqësor që kanë në përgjithësi të rinjtë. Kryesisht, sipas ekspertëve të rinjtë i lidhin përfitimet me të drejtën e lëvizjes në Union, akses në shkollim, mundësi për punësim dhe kushte me të mira në përgjithësi. Ata kanë një ide të përgjithshme për ekzistencën e rregullave, zbatimit të tyre, më shumë shërbime dhe një shtet që funksionon, por pak për hapat dhe reformat që duhet të ndërmarrë Shqipëria për ti realizuar këto procese. Sipas tyre, përfitimet e mundshme theksohen vazhdimisht në media, por aspekte më të thelluara si çështjet e të drejtave të njeriut apo dhe

¹¹⁰ Intervistë me Ardita Keraj (Korriku), përfaqësuese e Shoqatës Kombëtare Edukimi për Jetën, 11 nëntor.2019.

mundësitë për të shfrytëzuar mekanizmat mbrojtës nuk u jepet ndonjë peshë në media apo fushata informuese nga institucionet shtetërore.

Ekspertët vërejnë se sikundër dhe në rastin e njohurive për Bashkimin Europian dhe në lidhje me të drejtat e njeriut gjithashtu, mungon trajtimi i duhur i këtyre çështjeve në sistemin arsimor dhe se niveli i ulët i informimit të rinjve në qytete të vogla është i theksuar. Të informuar janë vetëm ata të rinjë që kërkojnë burime alternative informacioni, studiojnë në universitete në një degë relevante apo angazhohen në organizata të shoqërisë civile. Për ekspertin Brokaj “[...] të rinjtë kanë mungesë të madhe të kuptuarit që ata janë vetë pjesë e procesit, që do duhet të kontribuojnë e që përparimi dhe zgjidhja e problemeve varet nga ata dhe jo nga BE-ja”.¹¹¹ Sikundër dhe zbatimi i të drejtave themelore të njeriut duhet të jetë një angazhim që shteti duhet t’ a realizoj. Më tej, ajo thekson se:

“[...] ka qaq shkelje në jetën e përditshme, nga më të voglat tek më të mëdhatë (që nga mediat që abuzojnë me jeten private, me tekstet dhe titujt misogjene, me fotot e femijeve minore, diskriminimin dhe dhunen ndaj komunitetit LGBT etj.), por të rralla janë rastet kur të rinjtë i identifikojnë ato shkelje, e akoma me të rralla rastet kur ata veprojnë pas këtyre shkeljeve. Njohja vetëm e të drejtave dhe mungesa e reagimit për t’i mbrojtur ato është një problem serioz jo vetëm për të rinjtë por për të gjithë shoqërinë shqiptare”.¹¹²

Për ekspertin Elezi “[...] të rinjtë kanë shumë pak informacion mbi përfitimet dhe për të drejtat themelore kanë një informacion mbi të drejtat në përgjithësi kjo më tepër si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra nga zyra e Këshillit të Europës se sa si informacion në kuadër të BE-së”.¹¹³ Si konkluzion, edhe për këtë çështje sikundër dhe për njohurit në përgjithësi mbi BE-në tek të rinjtë rezulton një nivel i ulët i njohurive, të dhënat e marra nga pyetësorët lidhen dukshëm me rezultatet e intervistave duke na

¹¹¹ Intervistë me Alba Brokaj, *op.cit.*

¹¹² Ibid.

¹¹³ Intervistë me Gentian Elezi, *op.cit.*

dëshmuar për domosdoshmërinë e masave për sensibilizim dhe informim të shoqërisë, të rinjëve dhe të grupeve të marginalizuara në veçanti.

Një pyetje tjetër lidhet me evidentimin e tre përfitimeve kryesore që mund të ketë vendi nga anëtarësimi në BE. Për pjesën më të madhe të të intervistuarve përfitimet lidheshin me dy kategori të mëdha, si përfitime politike dhe ato ekonomike:

- Reformat e ndërmarra përpara anëtarësimi;
- Krijimi i një shteti ligjor dhe demokratik në funksionim të institucioneve;
- Forcimi i mekanizmave monitorues për zbatimin dhe funksionimin e ligjit;
- Vendosja e standardeve europiane dhe mënyra se si do vijnë në funksionim institucionet Shqiptare;
- Administrate me eficientë dhe e jo e politizuar;
- Zbatim më i mirë i standardeve të të drejtave të njeriut dhe forcim i shtetit të së drejtës – më shumë presion dhe mekanizma për të drejtat e njeriut;
- Më shumë mbështetje ekonomike, institucionale dhe infrastrukturore për shtetin shqiptar;
- Siguria dhe kontrolli i ushqimeve/produkteve;
- Konkurrenca e lirë, zhvillimi i lirë i tregtisë, lehtësira fiskale;
- Lëvizja e lirë e njerëzve;
- Më shumë fonde dhe akses në programet e BE-së.

Në tërësi mendimi i ekspertëve thekson se anëtarësimi sjell zhvillim shoqëror të gjithanshëm dhe shumëdimensional. Përfitimin kryesor padiskutim që është ai ekonomik dhe përmes tij synohet rritja e standardit të jetesës së qytetarëve dhe zbehja e sa më shumë problemeve sociale dhe aspekteve diskriminuese në shoqëri. Gjithashtu, zhvillimi ekonomik bënë të mundur dhe fuqizimin e shoqërisë në kuptimin e kulturës demokratike, e respektimit të të drejtave të njeriut, respektim të mjedisit etj., pra e të gjithë elementeve që përfaqësojnë standarde të Bashkimit Europian.

Disa nga kostot e trajtuara lidhen me:

- Konkurrencë e forte ekonomike me vende shumë të zhvilluara;
- Emigrimi i lartë i personave të kualifikuar dhe jo vetëm;
- Mungesë e demokracisë në vendimmarrjen e institucioneve të BE-së;
- Kufizim i sovranitetit shtetëror;
- Konkurenca në tregje të mëdha dhe kostot që duhet të paguajë biznesi vendas në infrastrukturë dhe teknologji për arritjen e standardeve të BE-së.

Ekspertët theksojnë gjithashtu se kostot lidhen me mënyrën se si është ndërtuar Bashkimi Europian. Konkurenca në aspektin ekonomik bëhet gjithnjë dhe më e vështirë. Që të përfitosh duhet që të jesh konkures, të jesh i përgatitur, gjë që nuk është kuptuar sa duhet dhe mund të jetë një mangësi në të ardhmen sepse nuk jemi gati për të përfituar nga mundësitë që ka BE-ja.

Së fundmi, të intervistuarit u pyetën nëse kuadri ligjor dhe institucional mundëson koordinimin e punës midis organizatave dhe institucioneve shtetërore për një informim të gjerë dhe cilësor të rinisë mbi integrimin europian, dhe nëse janë identifikuar mangësi në këtë drejtim. Për pjesën më të madhe të ekspertëve, kuadri ligjor e mundëson një gjë të tillë por ata theksojnë se mënyra si funksioni shteti në tërësi është problematike sepse në përgjithësi varet nga drejtuesit e institucioneve se sa vërtet i përdorin instrumentat ligjorë për një informim cilësor të qytetërëve. Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile kryesisht është sporadik dhe nuk është një prioritet i institucioneve. Sipas ekspertes Xhepa “kuadri ligjor dhe institucional e mundëson bashkëpunimin midis organizatave por në shumicën e rasteve është çështje vullneti sesa zbatim i një detyrimi për bashkëpunim institucional për të ndërmarrë nisma mbi informimin për proceset e integrimit”.¹¹⁴ Ndërsa për Komisionerin Gajdja “mangësia më e madhe është në aspektin e organizimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional [...] Shpesh herë aktorë të ndryshëm bëjnë të njëjtën gjë, ku nuk informohen për punët që bëjnë të tjerët, në mënyrë që këto energji ti

¹¹⁴ Intervistë me Ina Xhepa, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Europiane, 22 nëntor.2019.

kanalizojnë në një fushë tjetër pra ka një mosorganizim shtetëror dhe shoqëror në lidhje me shumë aspekte”.¹¹⁵ Gjithashtu, ekspertja Reçi thekson se kuadri ligjor e mundëson koordinimin dhe bashkëpunimin, por shumica e aktiviteteve dhe iniciativave ndërmerren nga OSHC-të.¹¹⁶ Sipas saj një nismë pozitive është dhe krijimi i këndeve të BE-së në bashkitë e vendit, por mënyra se si këto kënde funksionojnë në praktikë kërkon përmirësim të mëtejshëm.¹¹⁷ Një shembull konkret sipas Franceska Muço është fakti se grupet ndërinstitucionale të punës të PKIE 2018–2020 nuk kanë thirrur ndonjëherë për konsultim a përfshirje organizatat rinore apo të të rinjve në këto procese.¹¹⁸ Pavarësisht se ka disa strategji dhe plane veprimi që i përmendëm.

Në këtë drejtim ekspertët sugjerojnë nevojën për bashkëpunim periodik ndërmjet shumë aktorëve. Ata konstatojnë se nuk përdoret sa duhen instrumentet e konsultimit dhe informimit, të cilët janë ndërtuar por nuk zbatohen duke qënë se shpesh institucionet ‘kënaqen’ me përmbushjen e standardeve minimale. Pavarësisht që është detyrim ligjor, çështja e zbatimit të këtyre detyrimeve nuk është aktualisht në nivelin e duhur. Një mangësi konkrete lidhet me faktin e mungesës së përfshirjes së të rinjve në proceset informuese dhe planifikuese mbi çështje të lidhura me integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Konkluzione dhe rekomandime

Mbrojtja e të drejtave të njeriut përbën një nga shtyllat kryesore të procesit të demokratizimit të Shqipërisë dhe anëtarësimit të saj në Bashkimin Europian. Shqipëria ndër vite ka vazhduar me harmonizimin e kornizës ligjore me standardet e përcaktuara nga instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në rang kombëtar. Këto përpjekje të vazhdueshme kanë lejuar që të vërehet

¹¹⁵ Intervistë me Robert Gajdja, *op.cit.*

¹¹⁶ Intervistë me Megi Reçi, *op.cit.*

¹¹⁷ Ibid.

¹¹⁸ Intervistë me Franceska Muço, *op.cit.*

një përmirësim i mbrojtjes së këtyre të drejtave, por gjithsesi mbetet ende shumë punë për të bërë për të pasur një zbatim të plot të këtyre angazhimeve të ndërmarra nga shteti shqiptar.

Problematikat kryesore që hasen në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut lidhen me zbatimin në praktikë të kornizës ligjore, e cila është në nivel të kënaqshëm e përafuar me standardet më të mira në arenën ndërkombëtare. Në një sërë fushash vihet re se miratimi i ligjeve nuk shoqërohet në kohë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, të cilat me pas mundësojnë zbatimin e normave në fjalë. Duke u fokusuar në veçanti në fushën e mbrojtjes së të drejtave të katër grupeve vulnerabel, përkatësisht barazia gjinore, personat e komunitetit LGBTI, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e komuniteteve rome dhe egjiptiane, të katër strategjitë dhe planet e veprimit përkatëse hasin probleme konstante në nivel zbatimi për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare. Raportet e ndryshme evidentojnë këtë problematikë edhe në drejtim të zbatimit të kuadrit ligjor dhe atij institucional.

Një sfidë më vete mbetet dhe mundësia për të ndërmarrë një vlerësim të thelluar mbi nivelin e përmbushjes së angazhimeve të ndërmarra deri më tani në fushën e të drejtave të njeriut, përse kohë që mungojnë të dhënat dhe monitorimi i vazhdueshëm. Mungesa e analizave të kësaj natyre krijon pashmangshmërisht pengesa në hartimin e analizave dhe raporteve periodike.

Përballë kësaj shtate, perceptimet e shoqërisë në përgjithsi dhe e grupeve të marginalizuara në veçanti janë deri diku lehtësisht të hamendësueshme. Sikurse tregojnë edhe gjetjet e studimit tonë, shoqëria në përgjithësi dhe kategoria e grupeve të marginalizuara në veçanti kanë një mungesë të theksuar informacioni ku 80% e kampionit offline pranon se nuk ka aspak njohuri rreth BE dhe 60% e kampionit online se ka njohuri mesatare. Të dhënat tregojnë për ndryshime të theksuar në nivelin e njohurive në dy kampionët e studimit, kjo e kushtëzuar nga një mori faktorësh të analizuar përgjatë studimit. Gjithashtu mungesa e interesit për t’u informuar mbi çështje që lidhen me BE-në është e konsiderueshme tek të intervistuarit në

terren, ndëkohë pjesa e të anketuarve online jo vetëm që janë më të informuar por shfaqin një nivel tejet të lartë në masën mbi 90% për t’u informuar më shumë me çështje që lidhen me procesin e negociatave dhe anëtarësimit. Një rezultat i pritshëm ishte dhe fakti që të dy kampionët në përqindje të lartë rreth 88-90% janë pro integrimin të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Vlen për t’u theksuar mungesa e informacionit për ligje të një rëndësie të veçantë, siç është Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Informimin, ku mbi 60% e të anketuarve nuk e dinë që ekziston një bazë e tillë ligjore.

Për çështjen e zbatimit të të drejtave pothuajse për të drejtën e pronës dhe të drejtën për informim të dy kampionët ndajnë të njëjtin perceptim të mos zbatimit të tyre, sikundër dhe për arritjet minimale në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga shteti shqiptar gjatë 5 viteve të fundit. Një konkluzion i rëndësishëm është varësia që shikon në tërësi kampioni i studimit për lidhjen me avancimin e vendit në BE dhe përmirësimit të situatës ekonomike dhe zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes të të drejtave personale. Kjo lidhet me perceptimin pozitiv ndaj Bashkimi Europian që kanë shqiptarët në përgjithsi.

Shqetësuese mbeten rezultatet e marra në lidhje me trajtimin që grupet e marginalizuara. Duhet theksuar fakti që aktorë të shoqërisë civile dhe qytetarët të monitorojnë dhe raportojnë sa më shumë raste të tilla në mënyrë që të përmirësohen shërbimet. Mungesa e ulët e ankimit është prezente tek të dy kampionët. Sikundër edhe raporte apo studime të tjera kanë evidentuar dëshirën e shqiptarëve për tu larguar dhe të dhënat e marra në kuadër të këtij studimi tregojnë se 81% e të intervistuarve duan të largohen nga vendi, kryesisht për arsye ekonomike dhe mungesën e respektimit të të drejtave dhe lirive. Si përfundim, mund të themi se zhvillimet në vend dhe proceset integruese të perceptuara nga grupet e marginalizuara janë tejet pesimiste dhe kjo tregon hendekun dhe vështirësitë që hasin këto grupe në jetën e tyre të përditshme duke mos parë përmirësim të kushteve të tyre.

Rekomandime

- Institucionet shtetërore duhet të investojnë më shumë në drejtim të koordinimit, hartimit dhe hyrjes në fuqi në kohë të akteve nënligjore. Mosshoqërimi i ligjeve nga aktet nënligjore përkatëse krijon problematika të reja, të cilat nuk ndikojnë aspak në përmirësimin e një problematike apo situatë të caktuar.
- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi duhet të rishikohet në mënyrë që të adresojë konceptin e diskriminimit të shumëfishtë.
- Një vëmendje më e madhe i duhet dhënë trajnimeve të specializuara dhe të vazhdueshme për gjykatësit, prokurorët dhe punonjësit e organeve ligjzbatuese rreth përmbajtjes së ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.
- Institucionet shtetërore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet e dhëna nga institucionet e pavarura në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen nga mosdiskriminimi në veçanti.
- Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të fuqizohen me tej me burime njerëzore dhe financiare për të përmbushur misionin përkatës, si dhe për të ndërmarrë në rang vendi fushata të targetuara për respektimin e të drejtave të njeriut. Përpos aktiviteteve ndërgjegjësuere të ndërmarra deri më tani, nevojitet një intensifikim i punës në këtë drejtim për të mbuluar gjerësisht sidomos zonat suburbane dhe rurale.
- Vihet re që në disa sektorë (si p.sh. sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve) vetëm një pjesë e bashkive kanë investuar në ngritjen e strukturave përkatëse, duke kontribuar kështu në fragmentimin e mëtejshëm të punës. Për këtë arsye, nevojitet që kalimi i kompetencave nga niveli qëndron në atë lokal në drejtim të ofrimit të shërbimeve për grupet e marginalizuara duhet të shoqërohet njëkohësisht me reduktim të burokracisë, rritje të kapaciteteve të punonjësve dhe burime financiare të përshtatshme.
- Komuniteti rom dhe egjiptian vazhdojnë të mbeten të marginalizuar dhe me nivel arsimor të ulët për arsye ekonomike, mungesë të mbështetjes nga institucionet shtetërore, si dhe për arsye të diskriminimit në shoqëri. Nevojitet që të investohet në drejtim të

informimit dhe ndërgjegjësimit të këtij komuniteti në mënyrë të thjeshtuar mbi aspekte të ndryshme si p.sh. të drejtat dhe mundësitë që i lejon korniza ligjore në fuqi, thjeshtëzim i procedurave administrative, reduktim i distancës fizike midis zonës së banimit dhe zyrave të pushtetit lokal, etj.

- Përpos kushteve të vështira ekonomike, problematikë e vazhdueshme mbetet hendeku midis fëmijëve rom dhe egjiptian dhe pjesës tjetër që jetojnë në të njëjtën zonë, sikurse dhe niveli i segregimit të tyre në institucionet arsimore. Nevojitet një ndërhyrje sistematike dhe e qëndrueshme nga institucionet shtetërore për adresimin e këtyre sfidave, dhe në këtë drejtim duhet përmendur që edhe vet ministria përgjegjëse duhet të forcojë më tej kapacitetet.
- Në fushën e punësimit, komunitetet rom dhe egjiptiane shënojnë një nivel shumë të ulët të pjesëmarrjes. Aksesi i këtyre dy komuniteteve në shërbimet publike në përgjithësi mbetet i limituar. Ndaj nevojitet një rishikim i strategjisë së punësimit për të targetuar në mënyrë korrekte këtë problematikë, si dhe një qasje e strukturuar për t'i mundësuar këtij komuniteti një akses dhe përfitim nga skema e sigurimit shëndetësor.
- Nevojiten ndërhyrje konkrete për rritjen e ndërgjegjësimit midis punonjësve që ofrojnë shërbime publike, si kujdesi shëndetësor, edukimi, punësimi dhe strehimi, për një respektim të denjë të parimit të mosdiskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Raporte të ndryshme dhe gjetjet e studimit evidentojnë problematikë të hasura nga personat LGBTI në lidhje me aksesin dhe cilësinë e shërbimeve publike të ofruara.
- Një rol të konsiderueshëm për të mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI e luajnë organizatat e shoqërisë civile. Nevojitet një ndërhyrje kostante, e mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirëse nga ana e institucioneve shtetërore, e cila më pas plotësohet nga përfshirja e organizavata joqeveritare. Duke patur parasysh nivelin e stigmatizimit të këtij komuniteti, nevojitet një ndërhyrje për të rritur nivelin e përgjithshëm të ndërgjegjësimit të qytetarëve, sidomos në zonat rurale.

- Në drejtim të barazisë gjinore, ndonëse baza ligjore ka pësuar përmirësime të vazhdueshme, niveli i ndërgjegjësimit ligjor të grave dhe sidomos midis grupeve vulnerabël është shumë i ulët. Nevojitet që të ndërmerren aktivitete për promovimin e ndërgjegjësimit dhe informimit të këtyre kategorive.
- Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me barriera fizike dhe ekonomike të shumfishta në përditshmërinë e tyre. Në veçanti, nevojitet ende një vëmendje nga autoritetet shtetërore për të investuar në arsimimin të këtij komuniteti nëpërmjet një infrastrukture teknologjike me çmim të aksesueshme për familjet. Sikurse për kategoritë e tjera të marginalizuara, mungesa e buxhetimit të kornizës ligjore do të vazhdojë të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së personave PAK.
- Nevojitet hartimi i një strategjie shtetërore gjithpërfshirëse për rritjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi procesin e integritit në BE, kostot dhe përfitimet e vendit, si dhe rolin e qytetarit në këtë proces. Hartimi i strategjisë duhet të përfshijë dhe të punojë ngushtë me aktorët jo-shtetëror të angazhuar në terren në përditshmërinë e punës së tyre.
- Të katër grupet e marginalizuara të përfshira në këtë studim kanë nevojë të përftojnë më shumë informacione rreth të drejtave të tyre, rreth procesit të integritit të vendit në BE dhe se si të drejtat e tyre lidhen ngushtë me këtë proces. Duke patur parasysh nivelin e ulët të informacionit që ata disponojnë, nevojitet organizimi i fushatave ndërgjegjësuese të përshtatura për secilin target-grup dhe të shpjeguara në mënyrë të thjeshtëzuar. Në këtë drejtim, koordinimi i aktiviteteve mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile në terren do të mundësonte rritje të ndarjes së informacionit.

1. Referenca

Avokati i Popullit, *Raporti vjetor për aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit Janar – Dhjetor 2018*, Tiranë, Maj 2019.

European Commission, *Albania 2019 Report*, Commission Staff working Document, SwD(2019) 215 final, COM(2019) 260 final, Brussels, 29 Maj 2019.

Kathleen Imholz & Elsa Toska, *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Manual për administratën publike*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë Prezenca në Shqipëri, Tiranë, Qershor 2016.

Këshilli i Ministrave, *Raportim për vitin 2018 mbi ecurinë e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian*, Tiranë, Janar 2019.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *Raporti Vjetor 2018*, Tiranë, 1 Mars 2019.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020*, Tiranë, Mars 2016.

United Nations General Assembly, *National report submitted in accordance with paragraph 5 of the annex to Human Rights Council resolution 16/21. Albania*, Human Rights Council, working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/wG.6/33/ALB/1, Thirty-third session, 6–17 Maj 2019.

United Nations, General Assembly, *Compilation on Albania Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, Human Rights Council, Working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/wG.6/33/ALB/2, Thirty-third session, 6–17 Maj 2019.

United Nations, General Assembly, *Report of the working Group on the Universal Periodic Review* Albania*, Human Rights Council, Universal periodic review, A/HRC/42/4, Forty-second session, Agenda item 6, 9–27 Shtator 2019.

United Nations, General Assembly, *Summary of Stakeholders' submissions on Albania. Report of the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, Human Rights Council, working Group on the Universal Periodic Review, A/HRC/wG.6/33/ALB/3, Thirty-third session, 6-17 Maj 2019.

**“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor
për të drejtat e njeriut”**

Shtojca 1: Tabela plotësuese

Tabela 10: Interesi i kampionit të studimit mbi institucionet e BE-së

<i>Pyetja 6: Për cilin nga institucionet e mësipërme do të kishit interes të merrnit më shumë informacion:</i>
Nga rezultatet e të dy kampioneve del se:
N = 94 e të anketuar kërkojnë të dinë për Gjykatën Europiane
N = 81 e të anketuar për Parlamentin Europian
N = 40 e të anketuar për Këshillin Europian
N = 30 e të anketuar për të gjitha
N = 26 e të anketuar për Këshillin e BE-së
N = 25 e të anketuar për Komisionin Europian

Tabela 11: Njohuri mbi institucionet e Bashkimit Europian (kampioni offline)

<i>Përshkrimi</i>	1=Aspak njohuri		2=Pak njohuri		3=Njohuri mesatare		4=Njohuri të mira		5=Njohuri shumë të mira		Pa përgjigje	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Parlamenti Eurobian	16 4	54.5%	66	22%	33	11%	15	5%	23	7.6%		
Komisioni Eurobian	17 7	58.8%	55	18.3%	28	9.3%	15	5%	21	6.9%	5	1.7%
Këshilli Eurobian	17 0	56.5%	56	18.6%	33	11%	12	3.9%	23	7.6%	7	2.3%
Gjykata Eurobiane	17 1	56.8%	66	22%	24	8%	13	4.3%	24	8%	3	1%
Këshilli (i BE-së)	18 1	60.1%	50	16.6%	26	8.6%	15	5%	22	7.3%	7	2.3%

Tabela 12: Njohuri mbi institucionet e Bashkimit Europian (kampioni online)

<i>Përshkrimi</i>	1=Aspak njohuri		2=Pak njohuri		3=Njohuri mesatare		4=Njohuri të mira		5=Njohuri shumë të mira	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Parlamenti Eurobian	10	8.2%	28	22.9%	42	34.4%	29	23.8%	13	10.7%
Komisioni Eurobian	8	6.6%	34	27.9%	39	32%	32	26.2%	9	7.4%
Këshilli Eurobian	12	9.8%	26	21.3%	45	36.9%	27	22.1%	12	9.8%
Gjykata Eurobiane	12	9.8%	35	28.7%	37	30.3%	20	16.4%	18	14.7%
Këshilli (i BE-së)	12	9.8%	28	22.9%	46	37.7%	25	20.5%	11	9%

Tabela 13: Vlerësimi i politikave të BE-së (kampioni offline)

<i>Përshkrimi</i>	1=Aspak e rëndësishme		2=Pak e rëndësishme		3=Indiferente/e,		4=E rëndësishme,		5=Shumë e rëndësishme		Pa përgjigje	
Politika e zgjerimit ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor	77	25.6%	44	14.6%	49	16.3%	79	26.2%	49	16.3%	3	1%
Demokracia, respektimi i të Drejtave Themelore të Njeriut dhe pakicave në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	64	21.3%	44	14.6%	45	15%	73	24.3%	72	23.9%	3	1%
Zhvillimi politik dhe ekonomik në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	64	21.3%	44	14.6%	50	16.6%	89	29.6%	50	16.6%	4	1.3%
Zhvillimi social dhe kulturor në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	68	22.6%	35	11.6%	46	15.3%	88	29.2%	56	18.6%	8	2.6%

Tabela 14: Vlerësimi i politikave të BE-së (kampioni online)

<i>Përshkrimi</i>	1=Aspak e rëndësishme		2=Pak e rëndësishme		3=Indiferente/e,		4=E rëndësishme		5=Shumë e rëndësishme	
Politika e zgjerimit ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor	6	4.9%	17	13.9%	15	12.3%	29	23.8%	55	45%
Demokracia, respektimi i të Drejtave Themelore të Njeriut dhe pakicave në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	4	3.3%	7	5.7%	19	15.6%	22	18%	70	57.4%
Zhvillimi politik dhe ekonomik në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	3	2.5%	18	14.8%	16	13.1%	26	21.3%	59	48.4%
Zhvillimi social dhe kulturor në shtetet anëtare dhe shtetet aspirante	2	1.6%	17	13.9%	18	14.8%	31	25.4%	54	44.3%

“Perceptime mbi integrimin në BE dhe zbatimin e kuadrit ligjor për të drejtat e njeriut”

Tabela 15: Fushat e informacionit rreth BE-së (kampioni offline)

<i>Përshkrimi</i>	Po		Jo		Nuk e di		Pa përgjigje	
Historia e BE-së	114	37.9%	114	37.9%	67	22.25%	6	2%
Politikat e BE-së	131	43.5%	100	33.2%	59	19.6%	11	3.7%
Procesi i negociatave dhe anëtarësimi në BE	160	53.1%	76	25.25%	59	19.65%	6	2%
BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor	167	55.5%	73	24.25%	54	18%	7	2.3%
Procesi i Stabilizim-Asociimit me BE-në	144	47.8%	96	31.9%	52	17.3%	9	3%
Tjetër (specifiko)								

Tabela 16: Fushat e informacionit rreth BE-së (kampioni online)

<i>Përshkrimi</i>	Po		Jo		Nuk e di	
Historia e BE-së	79	64.8%	30	25%	13	10.7%
Politikat e BE-së	100	82%	12	9.8%	10	8.2%
Procesi i negociatave dhe anëtarësimi në BE	112	92%	5	4%	5	4%
BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor	112	92%	4	3.2%	6	4.9%
Procesi i Stabilizim-Asociimit me BE-në	98	80.3%	8	6.6%	16	13.2%
Tjetër (specifiko)						

Shtojca 4: Lista e të intervistuarve

Emri Mbiemri	Institucioni
Ardita Keraj (Korriku)	Shoqatës Kombëtare Edukimi për Jetën
Megi Reçi	Civil Rights Defenders
Robert Gajdja	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Gledis Gjipali	Lëvizjes Europiane për Shqipërinë
Xheni Karaj	Aleanca LGBT
Ina Xhepa,	Qendra Europiane
Gentian Elezi	Instituti Agenda
Alba Brokaj	Përfaqësuese Speciale e Shqipërisë për Rininë dhe Sigurinë pranë OSBE-së
Lutjona Lula	ESN Tirana
Françeska Muço	Rrjetit të Profesionistëve të Rinj